



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

“AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT, TIRANË”

Tiranë, Dhjetor 2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe
Rekreacionit”, Tiranë

Përmbajtja	Faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
II. HYRJA.....	8
c) <i>Objektivat dhe qëllimi.</i>	8
d) <i>Identifikimi i çështjes.</i>	8
e) <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</i>	12
f) <i>Përgjegjësitë e audituesve.</i>	12
g) <i>Kriteret e vlerësimit.</i>	12
f) <i>Standardet e auditimit.</i>	14
III. PËSHKRIMI AUDITIMIT	15
1. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	16
2. Vlerësimi i procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit të njësisë	23
3. Auditimi i mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016.	26
4. Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në lidhje me:	27
-Llogaritë e të ardhurave, të krijuara apo përfituar gjatë periudhës	28
-Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj.),.....	28
5. Mbi zbatimin e kërkesave të Prokurimit Publik.....	31
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	44
V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT	47
VI. ANEKSE	Error! Bookmark not defined.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

Lista e shkurtimeve

KLSH	-Kontrolli i Lartë i Shtetit
APR	-Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
VKM	-Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVRPP	-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive
INTOSAI	-International Organisation of Supreme Audit Institutions
ISSAI	- International Standards of Supreme Audit Institutions
MF	-Ministria e Financave
DP	-Drejtori e Përgjithshme
VKB	-Vendim i Këshillit Bashkiak
PBA	-Projekt Buxheti Afatmesëm
APP	-Agjencia e Prokurimit Publik
KPP	-Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
OE	-Operator Ekonomik
TVSH	-Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
AK	-Autoriteti Kontraktor
DPQ	-Drejtorja e Policisë Qarkut
QKL	-Qendra Kombëtare e Liçensimit
DST	-Dokumente Standard të Tenderit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit Nr. 879/1, datë 24.08.2017 të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 28.08.2017 deri në datën 20.10.2017, në subjektin “Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit” Tiranë, për periudhën nga 15.07.2015 deri në 30.06.2017 u krye auditim përputhshmërie mbi dhënien e një opinioni profesional, të pavarur mbi ndjekjen nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe përputhshmëria me ligjet dhe rregullat e raportimit financiar në sektorin publik. Qëllimi i projektit të auditimit ishte vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së APR me kuadrin rregullator në fuqi (ligjet, aktet normative & administrative, rregulloret, kontratat, marrëveshjet etj.) në fushën e drejtimit & menaxhimit, të buxhetit, të financës, burimeve njerëzore e materiale etj. për periudhën objekt i auditimit nëpërmjet evidentimit të të metave dhe mangësive (mospërputhjeve) në lidhje me rregullshmërinë e procedurave sipas legjislationit dhe rregullave të funksionimit të miratuara për APR, vlerësimit të realizimit të të ardhurave dhe administrimit të tyre, shpenzimet, vlerësimit të transparencës me publikun dhe biznesin dhe ballafaqimit dhe diskutimit të rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe në bazë të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, ka marrë Vendimin nr. 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit” ku në pikën 2 miratohet krijimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë me detyrat përkatëse funksionale. Gjithashtu në këtë vendim janë përcaktuar numri i punonjësve, niveli i pagave, logo, vula dhe përballimi i shpenzimeve për vitin 2015 nga buxheti i Drejtorisë nr. 1 të punëtorëve të qytetit.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nr. 14424/1, datë 5.10.2015 është bërë emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të APR i cili është përcjellë zyrtarisht APR me shkresë nr. 1692, datë 01.10.2015. Në këtë datë ka filluar veprimtarinë APR me NIPT/SSN L52205451C, në bazë të certifikatës së regjistrimit nr. 10150271398 të lëshuar në datën 05.10.2015 nga DP e Tatimeve.

Duke qenë një njësi e re dhe për shkak të numrit jo voluminoz të transaksioneve dhe veprimtarisë, auditimi u krye në mënyrë të një pas njëshme duke përfshirë të gjitha transaksionet dhe procedurat për periudhën objekt i auditimit. Auditimi u mbështet në evidencën e grumbulluar në format elektronik dhe dokumenta, në pyetësor dhe intervista dhe në komunikim e ballafaqim të vazhdueshëm me subjektin ku si rezultat veprimtaria audituesae si dhe gjetjet e konkluzionet u përshkruan respektivisht në 4 aktkonstatime dhe 5 aktverifikime për një pjesë të të cilave përfaqësuesit e subjektit paraqitën observacionet e tyre të cilat u vlerësuan me korrektesë dhe u paraqit në raport qëndrimi i grupit të auditimit. Në përfundim të punës audituese në terren, mbështetur në rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit u përgatit projektraporti i auditimit i cili u përcoll në APR me shkresë nr. 879/2, datë 21.11.2017. APR pasi u njoh me projektraportin, konfirmoi dalordësinë me konkluzionet përkatëse me shkresë nr. 1835/1, datë 22.11.2017, protokolluar në KLSH me nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

879/3, datë 24.11.2017. Grupi i auditimit paraqiti me e-mail drejtuesve të APR predispozicionin për një takim përfundimtar mirëkuptimi në ambientet e KLSH midis niveleve drejtuese në bazë të rregullave dhe standardeve të auditimit të KLSH për të cilin APR njoftoi me e-mail pamundësinë për të marrë pjesë për shkak të angazhimeve si dhe për faktin se nuk kishin objeksione apo çështje mosdakordësie për të diskutuar, duke kërkuar mirëkuptimin e grupit të auditimit për pamundësinë e organizimit të takimit. Grupi i auditimit, përgatiti këtë raport përfundimtar auditimi me gjetjet, rekomandimet dhe opinionin e auditimit si më poshtë vijon.

GJETJET DHE REKOMANDIMET, Faqe e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezulton se për periudhën objekt i auditimit në APR nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktiviteteve për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të përshkruara në rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative. APR nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara agjencisë. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim rezulton se në APR nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Rekomandim »Drejtori i Përgjithshëm i APR, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së APR, identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të APR duke marrë në konsideratë dhe prioritetet e Bashkisë Tiranë për funksionet në të ardhmen të APR.

b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktiviteteve për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

»Drejtori i Përgjithshëm i APR të caktojë një koordinator risku me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në APR për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshmëri dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të APR.

Rekomandimet sa më sipër, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

- Për vitin 2016 APR ka analizuar situatën dhe ka parashikuar nevojat për buxhetin e vitit 2016 në bazë drejtorish por që nuk është dokumentuar pasi si orientim kanë shërbyer udhëzimet e Bashkisë Tiranë për llogaritjen e nevojave sipas programeve bazë të buxhetit të institucionit të varësisë. Në këto kushte, APR pavarësisht se llogaritja e buxhetit për plotësimin e kërkesave në realizimin e funksioneve të ngarkuara për të ushtruar ka qenë në shifra më të larta pas negociemeve me strukturat e Bashkisë Tiranë në stadin final ka propozuar shifrat e rëna dakord të cilat janë miratuar plotësisht. Duke qenë se buxheti i miratuar nuk ka qenë në përputhje me nevojat reale të APR për vitin 2016, mbështetur dhe në shtimin e funksioneve gjatë vitit, janë realizuar shtesa fondesh gjatë vitit dhe rialokime të cilat janë miratuar në Këshillin Bashkiak respektivisht sipas propozimeve të rëna dakord midis APR dhe Bashkisë Tiranë. Në këto kushte në buxhetin final vjetor janë shtuar fonde në shumën 9,450,000 lekë nga Bashkia Tiranë në artikullin 600, 601 dhe 602 dhe totali i buxhetit paraqitet në shumën 374,450,000 lekë. Gjithashtu janë pakësuar gjatë vitit shpenzimet operative në shumën 10,515,360 lekë të cilat janë rialokuar në artikullin 231, investime. Shtesa e fondeve dhe rialokimi janë miratuar në strukturat kompetente të Bashkisë Tiranë sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi. Për vitin 2017, APR është përfshirë në procesin e përgatitjes së PBA 2017-2019, për Bashkinë Tiranë dhe buxhetin korent për vitin 2017. Në përfundim të procesit është propozuar programi buxhetor i APR në Bashkinë Tiranë me shkresë nr. 1147/2, datë 06.09.2016 sipas afateve të përcaktuara. Formalisht PBA e parashikuar dhe propozuar i qëndron programeve të institucionit të varësisë dhe argumentet parashikohen në relacionin mbi objektivat dhe prioritetet e APR afatmesme dhe ato vjetore. Në rubrikat e pasqyrave mbi parashikimet buxhetore evidentohet se në mënyrë skematike është respektuar programi buxhetor i Institucionit të Varësisë por nuk janë përshkallëzuar në nivel APR në kuptimin e parashikimit dhe llogaritjes së nevojave sipas objektivave të programit me aktivitete të cilat bëjnë të mundur realizimin e objektivave të programit.

Rekomandim »Njësia e Planifikimit dhe Administrimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të marrin masa për të organizuar procesin e përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm dhe atë të vitit korrent sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet vjetore të Ministrisë Financave për përgatitjen e projektbuxhetit duke identifikuar nevojat reale për fonde dhe propozuar ato sipas gjendjes reale dhe jo sipas fondeve të rëna dakord me strukturat përkatëse në Bashkinë Tiranë, pavarësisht nivelit të miratimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë. Fondet sipas programeve të lidhen me politikat dhe objektivat e programit dhe të shtrihen në nivel aktiviteti për të argumentuar domosdoshmërinë e fondeve të kërkuara duke përmirësuar punën e nisur në projektbuxhetin e vitit 2017 dhe përafruar me standardet dhe procedurat e përgatitjes së projektbuxhetit sipas përcaktimeve në aktet normative relevante në fuqi, kryesisht Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet periodike të MF për përgatitjen e PBA dhe projektbuxhetit të vitit korrent.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

- Gjatë vitit 2016, në tre procedura prokurimi është evidentuar mos sigurimi i dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike pasi Autoriteti Kontraktor ka skualifikuar operator ekonomik për aspekte që formalisht përputhen me përcaktimet ligjore por që mund të trajtoheshin lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.” të cilat do të krijojnë mundësinë e shpalljes fitues të OE të skualifikuar me ofertë më të ulët duke siguruar kursimin e fondeve në shumën prej 3,927,556 lekë.

Rekomandim »Autoriteti Kontraktor, APR, të marrë masa që KVO në të ardhmen të mund të jenë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave për kualifikim, sidomos ato të veçanta, dhe të mos hezitojë të kërkojë informacione shtesë dhe shpjegime nga OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të APR duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar duke u mbështetur në përcaktimet e kuadrit rregullator në fuqi për trajtimin e deviacioneve të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës me qëllim menaxhimin sa më ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve publike.

OPINIONI AUDITIMIT, Faqe e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në bazë të punës audituese të kryer, të përshkruar në Kreun II të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Grupit të Auditimit i rezulton se veprimtaria e APR, për periudhën 2015-2017, është në përputhje në çdo aspekt material me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, Kreu I, germa g) të Raportit Përfundimtar të Auditimit për sa i përket: (i) Mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016, respektimit të afatit të nxjerrjes së bilancit kontabël, plotësimit të pasqyrave financiare, (ii) Ndarjes së aktivitetit të ish-Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1, të Punëtorëve të Qytetit Tiranë me APR si përsa i përket transferimit të të drejtave dhe detyrimeve ashtu dhe për personelin dhe aktivet, (iii) Saktësisë së paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare, (iiii) Pasqyrimit të të ardhurave në tërësi dhe ato dytësore në veçanti në kontabilitet, (iiiii) Menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrimit të marrëdhënieve të punës, (iiiii) Llogaritjes, likuidimit dhe administrimit financiar të pagave, shpërblimeve dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, (iiiii) Administrimit, ruajtjes, dokumentimit dhe qarkullimit të vlerave materiale dhe monetare, veprimeve nëpërmjet bankës, (iiiii) Zbatimit të kontratave, kontrollit fizik dhe marrjes në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve, pasqyrimit në shpenzimet e periudhës kontabël, (iiiii) Regjistrimit të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, kontabilizimit të tyre, inventarizimit dhe amortizimit respektiv.

Gjithashtu veprimtaria e APR përputhet me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për sa i përket: (i) Funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit me përjashtim të funksionimit të APR jo në bazë të strategjive periodike të mirë përcaktuara, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, (ii) Procesit të programimit të buxhetit të njësisë me përjashtim të propozimit të nevojave jo sipas analizës dhe gjendjes reale të APR por sipas konkluzioneve të negociatave me Bashkinë Tiranë, jo sipas përcaktimeve në ligjet dhe udhëzimet periodike të përgatitjes së projektbuxheteve, (iii) Prokurimit të fondeve për mallra dhe shërbime me përjashtim të 5 procedurave ku Autoriteti



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

Kontraktor duhej të mbështetej më shumë tek qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve dhe jo strikt i vlerësimit të kërkesave për kualifikim të Operatorëve Ekonomik, tre çështjet e fundit trajtuar në Kreun. III, Gjetje dhe Rekomandime.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit Nr. 879/1, datë 24.08.2017 të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 28.08.2017 deri në datën 20.10.2017, në subjektin “Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit” Tiranë, për periudhën nga 15.07.2015 deri në 30.06.2017 u krye auditimi “Mbi dhënien e një opinionit profesional, të pavarur mbi ndjekjen nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe përputhshmëria me ligjet dhe rregullat e raportimit financiar në sektorin publik, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Albert Thoma, Përgjegjës Grupi
2. Anesti Gjika, Auditues

- a) **Titulli.** Auditim mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së APR me kriteret dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, Kreu I, germa g).
- b) **Marrësi.** Drejtori i Përgjithshëm i APR dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, Institucioni epror direkt i APR.
- c) **Objektivat dhe qëllimi.** Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së APR me kuadrin rregullator në fuqi (ligjet, aktet normative & administrative, rregulloret, kontratat, marrëveshjet etj.) në fushën e drejtimit & menaxhimit, të buxhetit, të financës, burimeve njerëzore e materiale etj. për periudhën objekt i auditimit nëpërmjet:
 - Evidentimit të të metave dhe mangësive (mospërputhjeve) në lidhje me rregullshmërinë e procedurave sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara për APR.
 - Vlerësimit të realizimit të të ardhurave dhe administrimit të tyre, shpenzimet.
 - Vlerësimit të transparencës me publikun dhe biznesin.
 - Ballafaqimit dhe diskutimit të rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.

Formulimi i rekomandimeve, në bazë të konkluzioneve, opinioneve dhe gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, për shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen.

- d) **Identifikimi i çështjes.** Auditimi u krye sipas drejtimeve të mëposhtme, të miratuara në Programin e Auditimit Nr. 879/1, datë 24.08.2017.

I. Auditimi do të fokusohet në vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të dhënë një opinion mbi nivelin e sigurisë që japin sistemet e kontrollit të brendshëm, duke parë por pa u limituar në elementët që garantojnë këto sisteme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

- Mjedisi i kontrollit.
- Menaxhimi i riskut.
- Aktivitetet e kontrollit.
- Informim komunikimi.
- Monitorimi

II. Vlerësimi i procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit të njësisë.

- a. Vlerësimi i nevojave dhe përputhja e tyre me objektivat si element kyç për të garantuar një programim të kujdesshëm për një buxhet sa më kredibël. Zbatimi i kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit. Nivelet e realizimit të planit përfundimtar.
- b. Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në raportimin e saktë të zërave të buxhetuar, analiza e deviancave të konstatuara.
- c. Vlerësimi i saktësisë së raportimit të të dhënave të buxhetit në zërat e pasqyrave financiare, për të dhënë një opinion të drejtë mbi saktësinë e pasqyrës së realizimit të buxhetit referuar bazës së dhënies së këtij opinionit.

III. Auditimi i mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016.

- a. Nxjerrja e bilancit kontabël me afat, plotësimi i pasqyrave financiare në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar.
- b. Auditim mbi mënyrën e ndarjes së aktivitetit të ish Drejtorisë Përgjithshme nr.1, të Punëtorëve të Qytetit Tiranë dhe zbatimi i procedurave të caktuara për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar, të prekur nga riorganizimi i Ndërmarrjes”;
- c. Dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare. Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Vlerësimi i gjendjes financiare të ndërmarrjes, detyrimet e konstatuara për fatura të palikujduara, vendime gjyqësore apo kredi të përfituara.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në lidhje me:

Llogaritë e të ardhurave, të krijuara apo përfituar gjatë periudhës

- a. Saktësia e pasqyrimit të të ardhurave sipas llojit të tyre (të krijuara vetë, grande, transferime nga buxheti, kredi apo financime të llojeve të ndryshme), paraqitja e drejtë e transaksioneve në kontabilitet. Rakordimet dhe sistemet e kontrollit për të ardhurat.
- b. Auditim me zgjedhje mbi organizimin, dokumentimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që realizohen nga aktivitetet prodhuese, shitja e biletave, nga Drejtoria e Parqeve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

dhe Rekreacionit, Sektori i gjelbërimit, Parku i madh pranë liqenit artificial, Kopshti zoologjik, Sektori i fidanishtes së bimësisë dekorative, etj.

- c. Evidentimi kontabël i të ardhurave nga aktiviteti dhe llogaritja e saktësisë së detyrimeve të përmbledhura në fund të periudhës
- d. Niveli granteve apo financimeve të huaja të përfituara dhe evidenca kontabël e tyre. Saktësia e paraqitjes në pasqyra financiare.

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj.).

- a) Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturave organike të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- b) Përcaktimi i pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me kod pune;
- c) Lidhja e kontratave të punës me punonjësit.
- d) Mbi vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë në zbatim të VKM nr.109, datë 26.02.2014” Për vlerësimin e rezultateve në punë të Nëpunësve Civilë”; i ndryshuar. (Njësia e Burimeve Njerëzore të paraqesë një listë të punonjësve në lidhje me trajtimin juridik të marrëdhënieve të punës të punonjësve civil dhe me kodin e punës).
- e) Respektimi i dispozitave ligjore për dhënien e shpërblimeve nga fondi i veçantë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.
- f) Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, konfirmimi i pagesës së sigurimeve si për stafin me status të nëpunësit civil dhe ata me kontratë.
- g) Saktësimi i vlerës së detyrimeve për paga dhe sigurime të pasqyruara në bilanc në fund të periudhës.

V. Mbi zbatimin e kërkesave të Prokurimit Publik

1. Hartimi i një table për Ndërmarrjen në lidhje me procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës lidhur, shtesat e kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedure prokurimi dhe audituar nga grupi/audituesi i KLSH në vlerë dhe në përqindje.

2. Përcaktimi i nivelit të shpenzimeve të prokuruar në referencë të totalit të shpenzimeve si dhe vlerësimi i zonave me risk për auditim. Dhënia e opinionit për rregullshmërinë e realizimit të procesit të prokurimit në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve.

a. Mallra dhe shërbime.

- 1. Mënyra e evidentimit dhe ndjekjes së nevojave për mallra dhe shërbime brenda ndërmarrjes. Niveli i deviacioneve nga programimi i buxhetit për këto zëra.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

2. Gjendja e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm. Kryerja i inventarit të aktiveve qarkulluese. Saktësia e vlerës së inventarëve ekonomik pasqyruar në pasqyrat financiare dhe konfirmimi i vlerës së inventarizimit fizik.
3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
4. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës lidhur me sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për aktivitetin e ndërmarrjes.
5. Analiza dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, kontroll i zbatimit të kontratës dhe marrja në dorëzim të mallrave/shërbimeve në referencë të kërkesave ligjore. Kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe verifikimi i zbatimit të kushteve të kontratës nga komisioni i ngritur për zbatimin dhe marrjen në dorëzim
6. Saktësia e vlerës së pasqyruar në shpenzimet e periudhës kontabël
7. Përcaktimi i vlerës së detyrimeve të papaguara nga blerjet e periudhave të mëparshme (lista e detyrimeve e saktësuar përmes testimeve të dokumentacionit të disponueshëm)
 - b. Aktiveve e Trupëzuara dhe të Patrupëzuara (230, 231)
 1. Regjistri i aktiveve dhe administrimi i pronës shtetërore
 2. Saktësia e vlerës së pasqyruar në aktive sipas klasifikimit bazë kontabël dhe llogaritja e amortizimit të tyre
 3. Shtesat e aktiveve gjatë vitit, dhe krahasimi me nevojat për investime të programuara. Argumentimi dhe përlllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për investime.
 4. Kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit. Zbatimi i kushteve të kontratës nga komisioni i ngritur për zbatimin dhe marrjen në dorëzim (Paraqitja në formë tabelore të objekteve ndërtimore të përfunduara sipas vlerës, operatori, fitues, data e kontratës, afatet e përfundimit të punimeve sipas kontratës, dhe përzgjedhja e tyre për verifikim në teren, etj.).
 5. Pakësimet e aktiveve dhe arsyet e këtyre transaksioneve. Ndjekja e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30 të Ministrisë së Financave
 6. Saktësimi i vlerave që prekin bilancin dhe konfirmimi i shifrës me inventarizimin fizik të realizuar në fund të periudhës. Verifikimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhur me administrimin e aktiveve të qëndrueshme.
 7. Përcaktimi i vlerës së detyrimeve të papaguara nga investimet e periudhave të mëparshme (lista e detyrimeve e saktësuar përmes testimeve të dokumentacionit të disponueshëm)
 8. Inventarizimi dhe krijimi i regjistrit/data base të aseteve të për periudhën e auditimit, auditimi i ndryshimeve të aseteve të kryera (dhënie me qira, shitje troje etj.), ligjshmëria dhe rregullariteti i veprimeve të kryera me asetet e qëndrueshme; Auditim mbi statusin juridik të tyre, regjistrimi në ZVRPP.

VI. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

- e) **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.**
- Për menaxhimin dhe funksionimin e APR përgjegjësia kryesore është e Drejtorit të Përgjithshëm i cili varet dhe jep llogari tek Kryetari i Bashkisë, Tiranë.
 - Për prokurimet publike përgjigjet Përgjegjësi i Sektorit të Prokurimeve i cili varet dhe jep llogari tek ZV/Drejtori i përgjithshëm i APR.
 - Për planifikimin dhe administrimin financiar përgjigjet Drejtori i Njesisë së Planifikimit dhe Administrimit Financiar i cili varet dhe jep llogari tek Drejtori i Përgjithshëm i APR.
 - Për burimet njerëzore dhe shërbimet përgjigjet Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve i cili varet nga Drejtori i Përgjithshëm i APR.
 - Për veprimtarinë teknike dhe operacionale përgjigjet Drejtori i Drejtorisë Teknike dhe Operacionale i cili varet dhe jep llogari tek Drejtori i Përgjithshëm.
 - Për administrimin e parqeve të hapura përgjigjet Drejtori i Parqeve të Hapura i cili varet dhe jep llogari tek Drejtori i Përgjithshëm i APR.
 - Për parqet tematike përgjigjet Drejtori i Administrimit të Parqeve Tematike i cili varet dhe jep llogari tek Drejtori i Përgjithshëm i APR.
 - Për projektimin dhe zhvillimin përgjigjet Drejtori i Projektimit dhe Zhvillimit i cili varet dhe jep llogari tek Drejtori i Përgjithshëm i APR.
 - Për rekreacionin përgjigjet Drejtori i Aktiviteteve rekreative i cili varet dhe jep llogari tek Drejtori i Përgjithshëm i APR.
 - Për pyjet dhe kullotat përgjigjet Drejtori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave i cili varet dhe jep llogari tek Drejtori i Përgjithshëm i APR.
 - Për kurorën e gjelbër përgjigjet Drejtori i Njesisë kurora e Gjellbër, Pylli Orbital i cili varet dhe jep llogari tek Drejtori i Përgjithshëm i APR.
- f) **Përgjegjësitë e audituesve.** Grupi i Auditimit të KLSH nëpërmjet veprimtarisë audituese ka ushtruar përgjegjësinë institucionale për zbatimin e programit të miratuar të auditimit, aplikimin e standardeve kombëtare e ndërkombëtare të auditimit sipas INTOSAI; për formulimin e konkluzioneve në mënyrë objektive në bazë të gjetjeve nga auditimi dhe për dhënien e opinioneve të pavarura, objektive dhe profesionale mbi drejtimit e auditimit në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së APR me kriteret dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Grupi i Auditimit ka ushtruar auditimin mbështetur në gjykimin profesional të audituesve duke respektuar kërkesat etike dhe planifikuar auditimin në nivel optimal për sigurimin e nivelit të kërkuar të sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së APR.
- g) **Kriteret e vlerësimit.** Gjatë auditimit, Grupi i Auditimit është mbështetur në kriteret e vlerësimit dhe kërkesat që burojnë nga kuadri rregullator në fuqi si më poshtë:
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
 - “Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015;
 - Rregullorja e Brendshme “ Për procedurat e auditimit të KLSH”
 - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
 - Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”
- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006;
- VKM nr.783, datë 22.11.2006 “ Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 14 , date 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe të njësisë të menaxhimit/ zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj;
- VKM nr.7, datë 09.01.1976 “Për dorëzimin e detyrës midis punonjësve”;
- VKM nr. 117, datë 05.03.2014” Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes se personelit” Aneksi 1 dhe II.
- VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve e grupimin e njësisë të qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr. 598, datë 27.04.2009 “për një ndryshim të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008”
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”;
- Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera te vogla”, i ndryshuar;
- Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe ta lartë”.
- Ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;
- Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar”;
- VKM nr. 54, date 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë të pasurive shtetërore”;
- VKM nr.500, datë 14.08.2001 ”Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.
- Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim;
- Rregulloret e Brendshme të funksionimit të administratës së Ndërmarrjes.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

-Vendimet apo urdhrat e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

f) **Standardet e auditimit.** Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100-999) të standardeve ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit të KLSH, ka adoptuar Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si standard pune.

Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të SAI mbi auditimin e përputhshmërisë. ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.” ISSAI 100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe zhvillon më tej ato duke i përcaktuar me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

ISSAI 4000 “Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”.

ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare.

Sipas përkufizimeve të ISSAI 4100;

“Autoritetet” janë akte ose rezoluta të lëshuara nga pushteti legjislativ apo instrumente të tje4ra statutore, direktiva dhe udhëzime të lëshuara nga organe të sektorit publik, me kompetenca të përcaktuara në statut, me të cilat subjekti i audituar duhet të jetë në pajtim.

“Audituesit e Sektorit Publik i planifikojnë dhe i kryejnë auditimet për të përcaktuar nëse informacioni mbi çështjen në të gjitha aspektet materiale, është në përputhje me kriteret e përcaktuara”.

“Për kryerjen e një auditimi që synon një nivel të arsyeshëm sigurie, audituesit e sektorit publik, mbledhin evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të mbështetur konkluzionet e tyre”.

ISSAI 300 “Parimet Bazë të Auditimit në lidhje me përputhshmërinë”, pohojnë se auditimi duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të paligjshme që mund të cenojnë ndjeshëm objektivat e auditimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe në bazë të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, ka marrë Vendimin nr. 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit” ku në pikën 2 miratohet krijimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë me detyra funksionale si më poshtë:

- a) Administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve memorialë (Varrezat e dëshmorëve Tiranë dhe Pezë) brenda territorit të B. Tiranë.
- b) Zhvillimi, Administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve rekreative (përfshirë parkun zoologjik), historike dhe natyrore brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
- c) Kthimi i parqeve, nëpërmjet planifikimit dhe projekteve, në zona rekreative të frekuentueshme nga çdo grup moshe.
- d) Mbrojtja e kurorave të gjelbëra dhe inspektimi i respektimit të zonave të gjelbëra brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Gjithashtu në këtë vendim janë përcaktuar numri i punonjësve, niveli i pagave, logo, vula dhe përballimi i shpenzimeve për vitin 2015 nga buxheti i Drejtorisë nr. 1 të punëtorëve të qytetit.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nr. 14424/1, datë 5.10.2015 është bërë emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të APR.

Vendimi sa më sipër është përcjellë zyrtarisht APR me shkresë nr. 1692, datë 01.10.2015. Në këtë datë ka filluar veprimtarinë APR me NIPT/SSN L52205451C, në bazë të certifikatës së regjistrimit nr. 10150271398 të lëshuar në datën 05.10.2015 nga DP e Tatimeve.

Aktivitetin e ka filluar me staf të transferuar nga DP Nr. 1 dhe rekrutuar rishtazi tremujorin e fundit të vitit 2015 brenda numrit 200 të punësuar të miratuar në vendimin e KB sa më sipër. Tremujorin e fundit 2015, ka kryer shpenzime për paga dhe operative si dhe për blerje me vlerë të vogël ku sipas bilancit të vitit 2015 rezultojnë në total në shumën 29,459,801 lekë dhe mbyllet viti 2015 me aktive në total 118,722,511 lekë. Gjatë kësaj periudhe është bërë kalimi i të drejtave dhe detyrimeve nga DP Nr. 1 e Punëtorëve të qytetit tek APR nëpërmjet komisioneve të përbashkëta me aktmarrëveshjet dhe procesverbalet përkatëse.

Për vitin 2016, janë planifikuar në buxhet shpenzime në total në shumën 374,450,000 lekë nga të cilat 153,600,000 lekë shpenzime për paga, 24,650,000 lekë shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, 90,484,640 lekë shpenzime operative dhe 105,715,360 lekë shpenzime për investime. Referuar pasqyrave financiare të vitit 2016, janë realizuar në total shpenzime në shumën prej 323,550,882 lekë nga të cilat 251,689,894 shpenzime korente dhe pjesa tjetër investime. Gjatë vitit 2016, janë bërë ndryshime ku konsistojnë në shtim të kompetencave dhe të stafit dhe si rezultat, viti 2016 mbyllet me një staf prej 266 punonjësish nga të cilët 106 administrata dhe pjesa tjetër teknike, nëpunës të thjeshtë, punëtorë dhe 20 punonjës të përkohshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

Në vitin 2017, në fund të periudhës së audituar, stafi përbëhet nga 278 punonjës.

Në një progres raport për arritjet e vitit 2016, janë përcaktuar objektivat madhor të vitit 2016, si më poshtë:

- Rigjallërimi dhe rimëkëmbja e Zoo Park
- Rehabilitimi, Rikualifikimi i Objekteve Rekreative dhe Sanitare në Parkun e Madh
- Krijimi i Shesheve dhe Parqeve të Reja Rekreative
- Gjallërimi i Aktiviteteve Rekreative

Si dhe janë përcaktuar objektiva madhor për vitin 2017 si më poshtë:

- Menaxhimi i aseteve të reja APR
- Mbështetje për Projektin e ri Zoo Park & Botaniku
- Rikualifikimi i Teatrit të Hapur
- Rikualifikim e ndërtim rrugica PMLAT
- Sinjalistika, Disiplinim, iPoint, monitorimi ZTK në PMLAT
- Tirana Ime Outdoor App
- Strategji & Projekt për Pyllin Orbital që përfshin Serrën dhe Fidanishten
- Parku i Farkës
- Parku Natyror Rajonal Pezë
- Luaj Tirana
- Shërbimi Pyjor, Prodhim e Shpërndarje
- Nxitja e Jetesës Aktive
- Nxitja e Jetesës së Gjelbër
- Rekreacioni Outdoor
- Propozim Tarifa të reja REJA, Teatri Veror, Treni, Varkat, Fushat, Parku i Aventurave (2018)
- Ëëbsite APR

1. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të dhënë një opinion mbi nivelin e sigurisë që japin sistemet e kontrollit të brendshëm, duke parë por pa u limituar në elementët që garantojnë këto sisteme:

- Mjedisi i kontrollit.
- Menaxhimi i riskut.
- Aktivitetet e kontrollit.
- Informim komunikimi.
- Monitorimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

Në zbatim të pikës I të programit të auditimit sa më sipër u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregulloret e organizimit dhe funksionimit të APR.
- Progres raporti i APR, viti 2016, në format elektronik.
- Përgjigje e kërkesave zyrtare të Grupit të Auditimit për Drejtore Drejtorie.
- Pyetësorët e përgatitura nga Grupi i Auditimit të plotësuar nga Specialistë dhe Përgjegjës Sektori.

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe në bazë të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, ka marrë Vendimin nr. 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit” ku në pikën 2 miratohet krijimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë me detyra funksionale si më poshtë:

- e) Administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve memoriale (Varrezat e dëshmorëve Tiranë dhe Pezë) brenda territorit të B. Tiranë.
- f) Zhvillimi, Administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve rekreative (përfshirë parkun zoologjik), historike dhe natyrore brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.
- g) Kthimi i parqeve, nëpërmjet planifikimit dhe projekteve, në zona rekreative të frekuentueshme nga çdo grup moshe.
- h) Mbrojtja e kurorave të gjelbëra dhe inspektimi i respektimit të zonave të gjelbëra brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Gjithashtu në këtë vendim janë përcaktuar numri i punonjësve, niveli i pagave, logo, vula dhe përballimi i shpenzimeve për vitin 2015 nga buxheti i Drejtorisë nr. 1 të punëtorëve të qytetit.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nr. 14424/1, datë 5.10.2015 është bërë emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të APR, z. Blendi Gonxhja.

Vendimi sa më sipër është përcjellë zyrtarisht APR me shkresë nr. 1692, datë 01.10.2015. Në këtë datë ka filluar veprimtarinë APR me NIPT/SSN L52205451C, në bazë të certifikatës së regjistrimit nr. 10150271398 të lëshuar në datën 05.10.2015 nga DP e Tatimeve.

APR është krijuar dhe regjistruar në DPT por në regjistrin elektronik të subjekteve nuk gjenerohet ekstrakt në bazë të NIPT të subjektit. Nga ballafaqimi rezulton se regjistrimi nuk është mbështetur në një statut apo akt themelimi por në VKB për këtë qëllim. APR nuk ka ndërtuar strategji afat mesme apo afat shkurtër. Nga ballafaqimi rezulton që veprimtaria e APR është më shumë dinamike dhe operative në funksion të realizimit të qëllimit për të cilin është krijuar e përcaktuar në VKB dhe e cituar më sipër në këtë informacion. Në një progres raport për arritjet e vitit 2016, janë përcaktuar objektivat madhor të vitit 2016, si më poshtë:

- Rigjallërimi dhe rimëkëmbja e Zoo Park
- Rehabilitimi, Rikualifikimi i Objekteve Rekreative dhe Sanitare në Parkun e Madh



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreative”, Tiranë

- Krijimi i Shesheve dhe Parqeve të Reja Rekreative
- Gjallërimi i Aktiviteteve Rekreative

Po në këtë material janë raportuar dhe arritjet kryesore për 2016, si më poshtë:

- ZOO: Rikthimi i publikut në Zoo Park, normalizimi i Zoo ekzistues, shërimi i specieve, kurimi i ZooParkut, siguria e rrethimet, strehimi e shpëtimi i 7 arinjve, GearBike falas; rritur 500% numri i vizitorëve; 4 specie të reja nga 16 që gjetëm
- PMLAT: Rikualifikimi i 8 objekteve rekreative e 1 sanitare, rikualifikimi i Fushave Sportive, 1 InfoPoint, 3 çezmat, Këndi i Forcës 2, Shtegu Japonez, Shkallë kalimi 2 te diga, Stola-Kosha-Palma përgjatë shëtitores te diga, Shatërvani lundruar në Liqen, 1000 Selvitë, Kopshti i Baballarëve & Bijat, Projekti “Parku i ri” përfundim, mbjellë 8000 pemë 32,000 Lule, Disiplinimi i dy hyrjeve të krahut lindor
- Parqe & Sheshe Rekreative të reja: Lu@j Tirana - 9 sheshe të reja dhe 4 në proces, 4 gati për të nisur; PPVTR030 - 16 Parqe të reja 2500 ha studim, hartografi, projekt ide; Pyllëzimi në Parkun e Farkës; aprovohet projekt propozimi për Park Rajonal Natyror në Pezë, Kat. IV; Marrëveshja me AKZM për Parkun e Dajtit,
- Aktivitetet Rekreative: Nxitja e Jetesës Aktive , 162 aktivitete/vit; 275,000 frekuentuese, kosto 32 Lek/frekuentues; Reja; TiranaImeOutdoor; Pedalon
- Përcaktimi i elementet që bene te mundur arrijten e objektivave
- Strukturimi; Mbështetja me personel e fonde nga BT; Partneritetet; Ngulmimi 365 ditët e vitit; Logjistika e përmirësuar; Rekrutimi cilësor; Promo; Disiplina; Motivimi

Si dhe janë përcaktuar objektiva madhor për vitin 2017 si më poshtë:

1:

- Menaxhimi i aseteve të reja APR
- Mbështetje për Projektin e ri Zoo Park & Botaniku
- Rikualifikimi i Teatrit të Hapur
- Rikualifikim e ndërtim rrugica PMLAT
- Sinjalistika, Disiplinim, iPoint, monitorimi ZTK në PMLAT

2:

- Tirana Ime Outdoor App
- Strategji & Projekt për Pyllin Orbital që përfshin Serrën dhe Fidanishten
- Parku i Farkës
- Parku Natyror Rajonal Pezë
- Luaj Tirana
- Shërbimi Pyjor, Prodhim e Shpërndarje



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

3:

- Nxitja e Jetesës Aktive
- Nxitja e Jetesës së Gjelbër
- Rekreacioni Outdoor
- Propozim Tarifa të reja REJA, Teatri Veror, Treni, Varkat, Fushat, Parku i Aventurave (2018)
- Ëëbsite APR

-Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezulton se nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitete për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të përkrahura në rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative.

-Nuk i është nënshtruar veprimtaria e APR që nga krijimi e deri në momentin e auditimit asnjë lloji auditimi të brendshëm, të jashtëm apo inspektimi financiar.

-Në APR nuk është ndërmarrë në mënyrë të strukturuar vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave apo detyrave funksionale si dhe nuk është dizajnuar harta e gjurmës së auditimit të APR. Përsa i përket vetëvlerësimit vjetor të veprimtarisë, APR nuk ka qenë subjekt i pyetësorit periodik të Njesisë së Harmonizimit të MF por në kuadër të Bashkisë së Tiranë, APR i është përgjigjur disa pyetjeve të drejtuara nga kjo e fundit në lidhje me risqet e mundshme që mund të kërcënojnë realizimin e investimeve.

Në prill të vitit 2016, është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, me nr. 10286/1, datë 22.04.2016 Rregullore e Organizimit dhe funksionimit të APR. Si rezultat i ndryshimeve në shtim të kompetencave dhe përgjegjësi si dhe të stafit, është përmirësuar rregullore e brendshme dy herë dhe miratuar me nr. 22107/1, datë 05.08.2016 dhe nr. 24478/3, datë 29.06.2017. Rregullorja është mbështetur në kuadrin rregullator në fuqi kryesisht legjislativ për njësitet e vetëqeverisjes vendore, legjislativ për marrëdhëniet e punës dhe funksionimin administrativ dhe VKB. Evidentohet se në bazën ligjore nuk është parashikuar ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Në rregullore janë parashikuar kompetencat dhe përgjegjësitë sipas strukturës së miratuar si dhe mënyra e raportimit e monitorimit. Në një farë mënyre janë instaluar kontrollet e brendshme sipas niveleve të strukturës.

APR ka konsideruar transparencën me publikun nëpërmjet mjeteve të komunikimit të saj dhe ato të bashkisë dhe ka ndërtuar dhe bërë funksionale faqen e saj në internet e cila është ende në proces përpunimi në disa rubrika të saj.

Drejtoria e Administrimit të Parqeve të Hapura:

Ushtron aktivitetin në mirëmbajtjen e parqeve rekreative ekzistuese 145 ha (Parku u Madh i Liqenit Artificial), parqe rekreative të reja 5.6 ha (Parqe dhe sheshe rekreative, Parqe të reja). – Raporton se ka realizuar trajnime të punonjësve për procese pune të thjeshta dhe procese pune specifike (Rregullore e Sigurimit Teknik) nuk dokumentohet. –Në objektivat dhe prioritetet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

raportohen kryesisht detyrat funksionale. –Përsa i përket risqeve raportohet dëmet e shkaktuara nga faktor objektiv natyror. –Përsa i përket strategjive raportohet se APR ushtron veprimtarinë në bazë të strategjive të miratuara të Bashkisë Tiranë. –Ka plane pune operative mujore.

Drejtoria e projektim Zhvillimit:

Ka organizuar punën në bazë të objektivave të përcaktuara në plane pune vjetore dhe mujore por që nuk figurojnë të miratuara. –Ka raportuar një hartë risku në terma të përgjithshëm por jo regjistër risku. –Ka strukturuar drejt misionin për çdo sektor, përgjegjësitë kryesore dhe të veçanta, kërkesat për çdo pozicion dhe skemën e varësisë dhe të raportimit e komunikimit. –Ka raportuar pjesëmarrje në trajnime dhe evenimente jashtë institucionit dhe i ka dokumentuar gjithashtu.

Njësia e pyllit orbital dhe kurorës së gjelbër:

–Ka strukturuar drejt misionin për çdo sektor, përgjegjësitë kryesore dhe të veçanta, kërkesat për çdo pozicion dhe skemën e varësisë dhe të raportimit e komunikimit. –Në objektivat dhe prioritetet raportohen kryesisht detyrat funksionale. –Përsa i përket risqeve raportohet dëmet e shkaktuara nga faktor objektiv natyror. –Përsa i përket strategjive raportohet se APR ushtron veprimtarinë në bazë të strategjive të miratuara të Bashkisë Tiranë. –Ka organizuar punën në bazë të objektivave të përcaktuara në plane pune mujore. –Në lidhje me trajnimet ka raportuar projektin mbi menaxhimin e parkut natyror rajonal, zhvilluar në maj 2017.

Drejtoria e Administrimit të Parqeve Tematike:

–Raporton se ka realizuar trajnime të punonjësve për procese pune të thjeshta dhe procese pune specifike (Rregullore e Sigurimit Teknik) nuk dokumentohet. –Në objektivat dhe prioritetet raportohen kryesisht detyrat funksionale. –Përsa i përket risqeve raportohet dëmet e shkaktuara nga faktor objektiv natyror. –Përsa i përket strategjive raportohet se APR ushtron veprimtarinë në bazë të strategjive të miratuara të Bashkisë Tiranë. –Ka plane pune operative vjetore dhe mujore. –Dokumentohen informacione periodike madje dhe propozime për masa disiplinore. –Ka strukturuar drejt misionin për çdo sektor, përgjegjësitë kryesore dhe të veçanta, kërkesat për çdo pozicion dhe skemën e varësisë dhe të raportimit e komunikimit.

Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

–Ka plane pune operative vjetore dhe mujore. –Raporton se ka realizuar trajnime të ftuar nga institucione jashtë APR. –Raportohet se funksionon komunikimi zyrtar midis strukturave të APR.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

–Ka të mirëpërckatuara objektivat e strukturës. –Dokumentohen informacione periodike madje dhe propozime për masa disiplinore. –Është strukturë e vogël dhe sigurohet efica dhe efektiviteti i strukturës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

Grupi i auditimit në bashkëpunim me APR konceptoi dhe shpërndau për tu plotësuar 58 pyetësor në nivel specialistësh dhe Përgjegjës Sektori pa identifikuar intervistuesin për të gjykuar mbi perceptimin mbi disa indikator performance kryesisht për vlerësim të funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve në tërësi të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nga administrimi i përgjigjeve rezulton si më poshtë:

1. Në vlerësimin tuaj si është impakti i APR si agjenci e re në varësi të Bashkisë Tiranë?

100% e përgjigjeve është impakt pozitiv.

2. Si paraqitet ngarkesa në punë gjatë vitit 2017 në krahasim me vitin 2016?

100% e përgjigjeve është më e lartë.

3. Sa të motivuar jeni në punën tuaj të përditshme?

93% nga 58 të intervistuar raportojnë se janë shumë të motivuar.

7% nga 58 të intervistuar raportojnë se presin më shumë.

4. Si paraqiten të ardhurat tuaja nga paga, shpërblimet dhe benefice të tjera nga natyra në vitin 2017 në raport me vitin 2016?

62% nga 58 të intervistuar raportojnë se kanë të ardhura më të larta.

30% nga 58 të intervistuar raportojnë se janë në të njëjtin nivel.

8% nga 58 të intervistuar raportojnë se kanë të ardhura më të ulëta.

5. Si është raporti i marrëdhënieve të eprorit tuaj me JU?

92% e të intervistuarve përgjigjen korrekte dhe 8% përgjigjen se nuk kanë marrëdhënie..

6. A jeni njohur zyrtarisht me detyrat e vendit të punës dhe të drejtat tuaja?

100% e përgjigjeve është pozitive.

7. A keni qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2016?

57% nga 58 të intervistuar raportojnë se kanë qenë pjesë e trajnimeve.

33% nga 58 të intervistuar raportojnë se nuk kanë qenë pjesë e trajnimeve.

6% nga 58 të intervistuar raportojnë se kanë qenë pjesë e trajnimeve jashtë institucionit.

4% nga 58 të intervistuar raportojnë se nuk kanë bërë asnjë trajnim.

8. A jeni njohur me strategjinë e APR për vitin 2016?

71% nga 58 të intervistuar raportojnë se janë njohur me strategjinë e APR për vitin 2016.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

17% nga 58 të intervistuar raportojnë se nuk janë njohur me strategjinë e APR për vitin 2016.

12% nga 58 të intervistuar raportojnë se janë njohur pjesërisht me strategjinë e APR për vitin 2016.

9. Nëse përgjigja e pikës 8 është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia e APR për vitin 2016?

45% nga 58 të intervistuar raportojnë se është reflektuar tek buxheti 2016.

12% nga 58 të intervistuar raportojnë se është reflektuar tek dokumenti i politikave.

43% nga 58 të intervistuar raportojnë se është reflektuar tek përshkrimet e detyrave për çdo vend pune.

10. Ku mbështeten marrëdhëniet tuaja të punës në APR?

54% nga 58 të intervistuar raportojnë se mbështeten tek statusi i nëpunësit civil.

34% nga 58 të intervistuar raportojnë se mbështeten tek kodi i punës.

12% nga 58 të intervistuar raportojnë se mbështeten tek kontrata individuale.

11. A keni dijeni dhe a keni nënshkruar formularin për vlerësimin periodik të punës tuaj?

67% nga 58 të intervistuar raportojnë po.

12% nga 58 të intervistuar raportojnë se nuk kanë dijeni.

21% nga 58 të intervistuar raportojnë jo.

Veçori për nivelin drejtues:

1. Në pozicionin e drejtuesit a jeni të përfshirë në vendimmarrjen e APR?

22% nga 32 të intervistuar raportojnë se janë të përfshirë në vendimmarrje.

43% nga 32 të intervistuar raportojnë se nuk janë të përfshirë në vendimmarrje.

25% nga 32 të intervistuar raportojnë se vetëm kur u kërkohet.

10% nga 32 të intervistuar raportojnë se kanë dhënë vetëm mendime.

2. Për realizimin e objektivave të njësisë që drejtoni sa mendoni se ushtroni kompetencat tuaja?

Nga 32 të intervistuar vetëm një raporton formalisht të tjerët i ushtrojnë kompetencat plotësisht.

3. A jeni përfshirë në procesin e rekrutimit përsa i përket plotësimit të stafit në njësinë që drejtoni?

38% nga 32 drejtues të intervistuar raportojnë se janë të përfshirë në procesin e vendimmarrjes.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

38% nga 32 drejtues të intervistuar raportojnë se nuk janë të përfshirë në procesin e vendimmarrjes.

26% nga 32 drejtues të intervistuar raportojnë se janë të përfshirë me raste në procesin e vendimmarrjes.

Përsa më sipër është mbajtur aktverifikimi nr. 3, datë 18.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1338/18, datë 18.10.2017 për të cilin nuk është paraqitur observacion nga APR.

2. Vlerësimi i procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit të njësisë.

1. Vlerësimi i nevojave dhe përputhja e tyre me objektivat si element kyç për të garantuar një programim të kujdesshëm për një buxhet sa më kredibël. Zbatimi i kriterëve dhe procedurave të hartimit të buxhetit. Nivelet e realizimit të planit përfundimtar.
2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në raportimin e saktë të zërave të buxhetuar, analiza e deviancave të konstatuara.
3. Vlerësimi i saktësisë së raportimit të të dhënave të buxhetit në zërat e pasqyrave financiare, për të dhënë një opinion të drejtë mbi saktësinë e pasqyrës së realizimit të buxhetit referuar bazës së dhënies së këtij opinion.

Në zbatim të pikës II të programit të auditimit, sa më sipër, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dosjet e planifikimit të buxhetit dhe zbatimit për periudhën 2015-2017.
- 2) Korrespondenca e APP dhe raportimet periodike me Institucionin e varësisë.
- 3) Librat e llogarisë dhe pasqyrat financiare për vitet 2015-2016.

Objekti i këtij verifikimi është verifikimi i procedurave në procesin përgatitjes së PBA për pjesët që takohet APR dhe buxhetet vjetore, vlerësimi i nevojave dhe përputhja e tyre me objektivat, nivelet e realizimit të planit përfundimtar, raportimi periodik në institucionin e varësisë dhe saktësia e raportimit të të dhënave të buxhetit në zërat e pasqyrave financiare për periudhën 2015-2016.

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe në bazë të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, ka marrë Vendimin nr. 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit” ku në pikën 2 miratohet krijimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu në këtë vendim janë përcaktuar numri i punonjësve, niveli i pagave, logo, vula dhe përballimi i shpenzimeve për vitin 2015 nga buxheti i Drejtorisë nr. 1 të punëtorëve të qytetit. Vendimi sa më sipër është përcjellë zyrtarisht APR me shkresë nr. 1692, datë 01.10.2015. Në këtë datë ka filluar veprimtarinë APR me NIPT/SSN L52205451C, në bazë të certifikatës së regjistrimit nr. 10150271398 të lëshuar në datën 05.10.2015 nga DP e Tatimeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

Për vitin 2015, në zbatim të VKB 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, Bashkia Tiranë ka dërguar njoftimin për ndryshimin e buxhetit për vitin 2015, me shkresë nr. 15088, datë 14/10/2015 në drejtim të Degës së Thesarit Tiranë dhe respektivisht Drejtorisë së Financës, DR nr. 1 të Punëtorëve dhe APR, sipas lidhjes 2, bashkëlidhur VKB ku për APR, për tremujorin e fundit të vitit 2015, është miratuar buxheti në shumë 27,000,000 lekë në Gr.00 Tit. 06260 Kp. 5, nga të cilat 20,600,000 lekë shpenzime personeli Artikulli 600; 3,400,000 lekë shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore Artikulli 601 dhe 3,000,000 lekë shpenzime operative Artikulli 602. Shpenzimet operative janë detajuar dhe raportuar në Bashkinë Tiranë, Drejtoria e Planifikimit Strategjik me shkresë nr. 222, datë 30/10/2015. Me të njëjtën strukturë është miratuar detajimi me shkresë nr. 16579, datë 02/11/2015 nga Bashkia Tiranë. APR ka respektuar kufijtë e miratuar të shpenzimeve dhe ka realizuar buxhetin për vitin 2015, referuar pasqyrave financiare të vitit 2015 të raportuara në Degën e Thesarit me nr. 394, datë 26.02.2016 për Paga, Shpërblime e të tjera personeli në shumën 22,918,596 lekë, Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në shumën 3,798,675 lekë dhe shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera në shumën 2,703,999 lekë.

Për vitin 2016 APR ka analizuar situatën dhe ka parashikuar nevojat për buxhetin e vitit 2016 në bazë drejtorish por që nuk është dokumentuar pasi si orientim kanë shërbyer udhëzimet e Bashkisë Tiranë për llogaritjen e nevoja sipas programeve bazë të buxhetit të institucionit të varësisë. Në këto kushte, APR pavarësisht se llogaritja e buxhetit për plotësimin e kërkesave në realizimin e funksioneve të ngarkuara për të ushtruar ka qenë në shifra më të larta pas negociemeve me strukturat e Bashkisë Tiranë në stadin final ka propozuar shifrat e rëna dakord të cilat janë miratuar plotësisht. Kështu për vitin 2016, me VKB nr. 58, datë 30.12.2015 është miratuar programi buxhetor afatmesëm dhe vitin korrent 2016 për Bashkinë Tiranë dhe respektivisht për APR si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë në shumën 365,000,000 lekë nga të cilat Shpenzime për paga në shumën 146,700,000 lekë, Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 23,100,000 lekë, Shpenzime materiale në shumën 100,000,000 lekë dhe Investime në shumën 95,200,000 lekë. VKB sa më sipër është dërguar në APR me shkresë nr. 2370, datë 25.01.2016. APR me shkresë nr. 123/1, datë 03.02.2016 ka kërkuar miratimin e detajimit të fondit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2016 i cili është miratuar pa ndryshime nga Bashkia Tiranë me shkresë nr. 4232, datë 09.02.2016 pas të cilit është parashikuar dhe miratuar dhe regjistri i parashikimeve për shpenzimet operative me shkresë nr. 342, datë 17.02.2016 pas të cilës ka filluar dhe procedura e prokurimeve publike. Duke qenë se buxheti i miratuar nuk ka qenë në përputhje me nevojat reale të APR për vitin 2016, mbështetur dhe në shtimin e funksioneve gjatë vitit, janë realizuar shtesa fondesh gjatë vitit dhe rialokime të cilat janë miratuar në Këshillin Bashkiak respektivisht sipas propozimeve të rëna dakord midis APR dhe Bashkisë Tiranë. Në këto kushte në buxhetin final vjetor janë shtuar fonde në shumën 9,450,000 lekë nga Bashkia Tiranë në artikullin 600, 601 dhe 602 dhe totali i buxhetit paraqitet në shumën 374,450,000 lekë. Gjithashtu janë pakësuar gjatë vitit shpenzimet operative në shumën 10,515,360 lekë të cilat janë rialokuar në artikullin 231, investime. Shtesa e fondeve dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

rialokimi janë miratuar në strukturat kompetente të Bashkisë Tiranë sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

Për vitin 2017, APR është përfshirë në procesin e përgatitjes së PBA 2017-2019, për Bashkinë Tiranë dhe buxhetin korrent për vitin 2017. Mbështetur në shkresën nr. 24220, datë 05.08.2016 të Bashkisë Tiranë mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019, Drejtori i Përgjithshëm i APR, ka urdhëruar me shkresë nr. 1147/1, datë 12.08.2016 ngritjen e Komisionit “Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019” të përbërë nga drejtuesit kryesor të drejtorive dhe njësive të APR të cilët kanë organizuar punën për përgatitjen e PBA sipas procedurave standarde të Udhëzimit të MF nr. 4, datë 29.02.2016. Në përfundim të procesit është propozuar programi buxhetor i APR në Bashkinë Tiranë me shkresë nr. 1147/2, datë 06.09.2016 sipas afateve të përcaktuara. Formalisht PBA e parashikuar dhe propozuar i qëndron programeve të institucionit të varësisë dhe argumentet parashikohen në relacionin mbi objektivat dhe prioritetet e APR afatmesme dhe ato vjetore. Në rubrikat e pasqyrave mbi parashikimet buxhetore evidentohet se në mënyrë skematike është respektuar programi buxhetor i Institucionit të Varësisë por nuk janë përshkallëzuar në nivel APR në kuptimin e parashikimit dhe llogaritjes së nevojave sipas objektivave të programit me aktivitete të cilat bëjnë të mundur realizimin e objektivave të programit. Me VKB nr. 84, datë 29.12.2016 është miratuar buxheti i Bashkisë Tiranë dhe respektivisht i APR si Njësi Buxhetore që varet nga Bashkia Tiranë në shumën 462,849,839 lekë nga të cilat 182,403,000 lekë shpenzime për paga, 28,820,000 lekë shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, 110,000,000 lekë shpenzime operative dhe 141,626,839 lekë shpenzime për investime. Gjatë 6-mujorit të parë 2017, janë realizuar disa ndryshime që konsistojnë në shtesa dhe rialokime të fondeve buxhetore të cilat nga ballafaqimi rezultojnë nga shtimi i funksioneve të APR gjatë vitit 2017. Këto ndryshime dhe rialokime janë miratuar në Këshillin e Bashkisë Tiranë.

Për periudhën 2015-2016, realizimi i buxhetit të APR paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

		Plani Progresiv 2015	Fakti Progresiv 2015	Detyrimet nga viti paraardhës	Detyrimet e vitit pasardhës	Total ne Bilanc 2015
600	Paga dhe shpenzime personale	16,000,000	14,071,126	0	8,847,475	22,918,601
601	Kontribute sig.shoqerore e shëndetësore	2,900,000	2,330,218	0	1,468,452	3,798,670
602	Shpenzime për mallra e shërbime operative	3,000,000	2,703,999	0	0	2,703,999
	Total	21,900,000	19,105,343	0	10,315,927	29,421,270

		Plani Progresiv 2016	Fakti Progresiv 2016	Detyrimet nga viti paraardhës	Detyrimet e vitit pasardhës	Total ne Bilanc 2016
600	Paga dhe shpenzime personale	143,660,000	143,347,929	8,847,475	13,629,424	148,129,878



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

601	Kontribute sig.shoqerore e shëndetësore	23,550,000	23,279,616	1,468,452	2,294,517	24,105,681
602	Shpenzime për mallra e shërbime operative	90,484,640	83,779,187	0	13,854,711	97,633,898
Total		257,694,640	250,406,732	10,315,927	29,778,652	269,869,457

Përsa më sipër është mbajtur aktverifikimi nr. 4, datë 20.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1631, datë 20.10.2017 për të cilin nuk është paraqitur observacion nga APR.

3. Auditimi i mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016.

1.Nxjerrja e bilancit kontabël me afat, plotësimi i pasqyrave financiare në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive qe varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar.

2.Auditim mbi mënyrën e ndarjes së aktivitetit të ish Drejtorisë Përgjithshme Nr. 1, të Punëtorëve të Qytetit Tiranë dhe zbatimi i procedurave të caktuara për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar, të prekur nga riorganizimi i ndërmarrjes”;

3.Dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare. Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Vlerësimi i gjendjes financiare të ndërmarrjes, detyrimet e konstatuara për fatura të palikujduara, vendime gjyqësore apo kredi të përfutuara.

Në zbatim të pikës III të programit të auditimit, sa më sipër, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Ditarët dhe Librat e Llogarisë për periudhën 2015-2016.
2. Pasqyrat financiare dhe bilanci për vitin 2016.
3. Aktet që shoqërojnë ndarjen aktivitetit midis DP nr. 1 të Qytetit dhe APR.

Objekti i këtij verifikimi është verifikimi i ndarjes së aktivitetit të DP nr. 1 të Punëtorëve të qytetit Tiranë dhe transferimi i të drejtave dhe detyrimeve, nxjerrja e bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare, saktësia e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare dhe detyrimet e konstatuara për fatura të pa likuiduara për vitin 2016.

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe në bazë të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, ka marrë Vendimin nr. 41, datë 23.09.2015 për “Riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit” ku në pikën 2 miratohet krijimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu në këtë vendim janë përcaktuar numri i punonjësve, niveli i pagave, logo, vula dhe përballimi i shpenzimeve për vitin 2015 nga buxheti i Drejtorisë nr. 1 të punëtorëve të qytetit. Vendimi sa më sipër është përcjellë zyrtarisht APR me shkresë nr. 1692, datë 01.10.2015. Në këtë datë ka filluar veprimtarinë APR me NIPT/SSN L52205451C, në bazë të certifikatës së regjistrimit nr. 10150271398 të lëshuar në datën 05.10.2015 nga DP e Tatimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

Përsa më sipër, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nr. 15772, datë 22.10.2015 për “Ndarjen e mjediseve të punës, mjeteve të punës, automjeteve, furnizimeve dhe gjendjes në magazinë për vitin 2015 ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të punëtorëve të Qytetit dhe Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit” është lidhur akt-marrëveshja nr. 221, datë 29.10.2015 midis dy institucioneve ku është ngritur komisioni i përbashkët me detyrë akt-dorëzimet për ndarjen sipas urdhrit. Në zbatim të akteve sa më sipër është realizuar ndarja sipas urdhrit me PV nr. 378/1, datë 31.12.2015 mbi marrjen në dorëzim nga APR të inventarit fizik dhe kontabël për Sektorët) Parku i Madh, Parku Memorial Varrezat e Dëshmorëve të Kombit Tiranë dhe Pezë dhe Kopshti Zoologjik); me PV nr. 378/2, datë 31.12.2015 mbi marrjen në dorëzim nga APR të inventarit fizik dhe kontabël për Sektorin Parku memorial (varrezat e Dëshmorëve të Kombit Tiranë dhe Pezë); me PV nr. 378/3, datë 31.12.2015 mbi marrjen në dorëzim të një pjese të bimësisë së serave; me PV nr. 378/4, datë 31.12.2015 mbi marrjen në dorëzim të inventarit fizik dhe kontabël për sektorin parku zoologjik; me PV nr. 378/5, datë 31.12.2015 mbi marrjen në dorëzim të inventarit fizik e kontabël për Sektorin Parku i Liqenit Tiranë (Parku i Madh); me PV të datës 03.11.2015 për ndarjen e mjediseve duke kaluar në përdorim të APR një pjesë e atyre të DP nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit Tiranë dhe me PV të datës 31.10.2015 për ndarjen e mjeteve të transportit dhe karburantit. Transferimi sa më sipër si dhe kalimi i të drejtave e detyrimeve përfshi dhe personelin rezultojnë në përputhje me përcaktimet sa më sipër dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.

APR ka depozituar pranë Degës së thesarit Tiranë bilancin e institucionit për vitin 2016 me shkresë nr. 475, datë 27.02.2017 sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 për “Kontabilitetin” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. APR ka mbyllur vitin 2016 me aktive të qëndrueshme të trupëzuara në shumën 281,406,791 lekë dhe aktive qarkulluese në shumën 63,483,788 të cilat përputhen me pasivin e bilanci nga fondet e veta në shumën 315,111,927 lekë dhe detyrime në shumën 29,778,652 lekë. Detyrimet janë afatshkurtra dhe përbëhen kryesisht nga detyrimet respektive për paga dhe të lidhura me to për muajin dhjetor 2016 në shumën 28,011,038 lekë dhe fatura të palikujduara në llogarinë 467 në shumën 1,767,614 lekë. Pasqyrat financiare janë plotësuar saktë dhe pa deviacione materiale, të ardhurat janë kryesisht nga buxheti i Bashkisë Tiranë dhe në shumën 1,862,600 lekë të ardhura të realizuara nga APR gjatë vitit 2016 nga shitja e biletave të kopshtit zoologjik. Totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave (Formati 3/1 dhe 3/2). Aktivët e qëndrueshme të trupëzuara janë rritur për vitin 2016 me 7,377,913 lekë (Balanca e vitit në formatin 4 korrespondon me postin e bilancit në aktiv, llogaria 231). Nuk u konstatuan mospërputhje materiale apo pasaktësi në plotësimin e pasqyrave financiare.

Përsa më sipër është mbajtur aktverifikimi nr. 5, datë 20.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1631/1, datë 20.10.2017 për të cilin nuk është paraqitur observacion nga APR.

4. Vlerësimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në lidhje me:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

-Llogaritë e të ardhurave, të krijuara apo përfituar gjatë periudhës

1.Saktësia e pasqyrimin të të ardhurave sipas llojit të tyre (të krijuara vetë, grande, transferime nga buxheti, kredi apo financime të llojeve të ndryshme), paraqitja e drejtë e transaksioneve në kontabilitet. Rakordimet dhe sistemet e kontrollit për të ardhurat.

2.Auditim me zgjedhje mbi organizimin, dokumentimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që realizohen nga aktivitetet prodhuese, shitja e biletave, nga Drejtoria e Parqeve dhe Rekreacionit, Sektori i gjelbërimit, Parku i madh pranë liqenit artificial, Kopshti zoologjik, Sektori i fidanishtes së bimësisë dekorative, etj.

3.Evidentimi kontabël i të ardhurave nga aktiviteti dhe llogaritja e saktësisë së detyrimeve të pa mbledhura në fund të periudhës

4.Niveli granteve apo financimeve të huaja të përfituara dhe evidenca kontabël e tyre. Saktësia e paraqitjes në pasqyra financiare.

-Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj.),

1.Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturave organike të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

2.Përcaktimi i pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me kod pune;

3.Lidhja e kontratave të punës me punonjësit.

4.Mbi vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë në zbatim të VKM nr.109, datë 26.02.2014” Për vlerësimin e rezultateve në punë të Nëpunësve Civilë”; i ndryshuar. (Njësia e Burimeve Njerëzore të paraqesë një listë të punonjësve në lidhje me trajtimin juridik të marrëdhënieve të punës të punonjësve civil dhe me kodin e punës).

5.Respektimi i dispozitave ligjore për dhënie e shpërblimeve nga fondi i veçantë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

6.Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, konfirmimi i pagesës së sigurimeve si për stafin me status të nëpunësit civil dhe ata me kontratë.

7.Saktësimi i vlerës së detyrimeve për paga dhe sigurime të pasqyruara në bilanc në fund të periudhës.

Në zbatim drejtimit të auditimit nr. IV të Programit të Auditimit sa më sipër, u krye vlerësimi përputhshmërisë dhe i rregullshmërisë në lidhje me;

1) Llogaritë e të ardhurave të krijuara apo përfituara gjatë periudhës.

2) Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj..



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

1-Në lidhje me përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë mbi të ardhurat e krijuara apo të përfituara rezulton që burimi kryesor i të ardhurave është buxheti i bashkisë i përbërë nga granti dhe të ardhurat e bashkisë si dhe të ardhurat nga shërbimet (shitja e biletave të parkut zoologjik).

Në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë realizohen të ardhurave dytësore vetëm nga shitja e biletave nga Kopshti Zoologjik, kjo në zbatim të Vendimit Nr. 59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore” në qytetin e Tiranës ku janë të përcaktuar vlera e biletave për hyrjen për fëmijë 50 lekë dhe për të rritur 100 lekë.

Nga evidenca e të ardhurave për muajin Tetor-Dhjetor 2015 nga sektori i kopshtit zoologjik janë arkëtuar 395,300 lekë.

Për vitin 2016 të ardhurat nga shitja e biletave nga sektori i kopshtit zoologjik janë 1,862,600 lekë, kjo e vërtetuar dhe sipas bilancit të institucionit për këtë vit.

Të ardhurat për periudhën Janar- Qershor 2017 nga shitja e biletave nga sektori i kopshtit zoologjik janë 2,245,100 lekë, kjo e vërtetuar nga akt rakordimet në fund të çdo muaj, të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i vetëm që realizon APR nga shitja e biletave të Parkut Zoologjik janë evidentuar në librat kontabël dhe nuk ka detyrime të pa mbledhura për të gjithë periudhën e auditimit.

2-Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore etj.) dhe nënpikat e tjera të cilat përcaktojnë strukturën organike, lidhjen e kontratave, vlerësimin e rezultateve të punës të punonjësve dhe respektimin e dispozitave ligjore për dhënien e shpërblimeve nga fondi i veçantë.

- Me Vendim Nr. 41, datë 23.09.2015, Bashkia e Tiranës dhe Këshilli Bashkiak vendosi riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës me një numër të përgjithshëm prej 200 (dyqind) punonjësish dhe detyrat kryesore funksionale si më poshtë;
- ❖ administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve memoriale (Varrezat e Dëshmorëve Tiranë dhe Pezë)
- ❖ zhvillimin, administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve rekreativ (parku zoologjik)
- ❖ mbrojtja e kurorave të gjelbra
- Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 dhe Buxheti i Aparatit të Bashkisë.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore kishte regjistrin themeltar të gjithë punonjësve në mënyrë manuale, gjithashtu çdo punonjës ishte i pajisur me dosje personale individuale, ku gjendeshin dokument identifikimi, librezë e punës, diploma e shkollës + notat, vërtetimi mjekësor, vërtetim nga prokuroria e gjykata, dëshmi penalteti, vërtetim nga njësia bashkiake dhe formulari i vlerësimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

- Për vitin 2016 Këshilli Bashkiak ka marrë Vendimin Nr. 38, datë 23.05.2016 për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe ka vendosur të miratojë një numër prej 20 punëtor për një periudhë 4 mujore (Qershor-Tetor).
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 69, datë 7.10.2016 për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar dhe ka vendosur të miratojë për shtyrje për një afat dy mujor (Tetor-Nëntor).
- Për vitin 2017 Këshilli Bashkiak ka marrë Vendimin Nr. 50, datë 31.05.2017 për APR t'i shtohen 7 (shtatë) punonjës, dhe numri total i punonjësve të APR të bëhet 278 punonjës, dhe Agjencisë ti shtohen dhe 20 punonjës me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për një periudhë 4 mujore (Qershor-30 Shtator).

a- Përcaktimi i pagave për vitin 2015 është bërë sipas vendimit Nr. 41, datë 23.09.2015, Bashkia e Tiranës dhe Këshilli Bashkiak ku ka miratuar nivelin e pagave sipas lidhjes së pagave nr. 15, bashkëlidhur këtij vendimi ku janë përcaktuar pozicioni, kategoria/klasa, vjetërsia, dhe shtesa për pozicionin, gjithashtu dhe vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar, master i shkencave, profesional, bachelor.

Për vitin 2017 përcaktimi i pagave është bërë sipas vendimit Nr. 36, datë 05.04.2017, Këshilli Bashkiak ku ka miratuar nivelin e pagave sipas lidhjes së pagave nr. 15, bashkëlidhur këtij vendimi ku janë përcaktuar pozicioni, kategoria/klasa, vjetërsia dhe shtesa për pozicionin, gjithashtu dhe vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar, master i shkencave, profesional, bachelor.

Marrëdhëniet e punës për të gjithë punonjësit rregullohen nga Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

b- Që nga krijimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë nga muaji Tetor 2015 e në vazhdim për të gjithë punonjësit janë lidhur kontrata individuale të punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe të firmosura ndërmjet palëve, rekrutimi i stafit të shtuar jo vetëm është në përputhje me kriteret dhe kërkesat e Kodit të Punës dhe atë të procedurave administrative, por në vlerësimin e kandidatëve për punësim sipas kërkesave të APR dhe vlerësimet vjetore të punës së tyre është konceptuar dhe strukturuar sipas përcaktimeve në aktet rregullatorë mbi statusin e nëpunësit civil pavarësisht se marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës, në mbështetje të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, VKM Nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar.

c- Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore u bë prezent lista e punonjësve dhe formulari i vlerësimeve e rezultateve të gjithë punonjësve të kësaj agjencie, ku janë përshkruar vlerësimet e performancës mbi bazën e arritjes së objektivave që përfshin një periudhë 12 mujore sipas shkallëve nga “Shumë mirë” me notën 5 dhe “Dobët” me notën 1, procedura e vlerësimit të performancës individuale, formulari i vlerësimit, vlerësimi i përgjithshëm, komentet nga eprori direkt dhe nënshkrimi nga të dyja palët.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

ç- Për vitin 2016 në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit janë dhënë shpërblime nga fondi i veçantë për 5 (pesë) punonjës, nga këta 4 punonjës për ndërprerje e marrëdhënieve të punës me Institucionin për shkak të daljes në pension pleqërie me leje vjetore e pakryer, i jepet në formë shpërblimi dhe një pagë mujore shtesë dhe për një punonjës një shpërblim leje vjetore e pakryer për shkak të suprimimit të vendit të punës. Këto në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 478, datë 16.06.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”; VKM Nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar

Për vitin 2017 nga ky Institucion janë dhënë ndihmë ekonomike për shkak sëmundjeje të rëndë për 2(dy) punonjës nga 30.000 (tridhjetë mijë) lekë secili, për ndërhyrje kirurgjikale dhe trajtim mjekësor të mëtejshëm, këto të vërtetuara dhe me dokumentacionin bashkëngjitur (fleta e shtrimit, epikriza etj.) në mbështetje të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 8487, datë 13.05.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar. Gjithashtu për këtë vit janë dhënë dhe 2 shpërblime për leje vjetore e pakryer 7 ditë kalendarike për punonjësit që lirohet nga detyra me dëshirën e tij, në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

d- Kontributi i sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale janë përlllogaritur dhe likuiduar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për të gjithë punonjësit e këtij institucioni.

e-Pagat dhe sigurimet shoqërore të pasqyruara në balance janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Përsa më sipër është mbajtur aktverifikimi nr. 2, datë 17.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1338/17, datë 17.10.2017 për të cilin nuk është paraqitur observacion nga APR.

5. Mbi zbatimin e kërkesave të Prokurimit Publik

1. Hartimi i një table për Ndërmarrjen në lidhje me procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës lidhur, shtesat e kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedure prokurimi dhe audituar nga grupi/audituesi i KLSH në vlerë dhe në përqindje.

2. Përcaktimi i nivelit të shpenzimeve të prokuruar në referencë të totalit të shpenzimeve si dhe vlerësimi i zonave me risk për auditim. Dhënia e opinionit për rregullshmërinë e realizimit të procesit të prokurimit në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

c. Mallra dhe shërbime.

1. Mënyra e evidentimit dhe ndjekjes së nevojave për mallra dhe shërbime brenda ndërmarrjes. Niveli i deviacioneve nga programimi i buxhetit për këto zëra.
2. Gjendja e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm. Kryerja i inventarit të aktiveve qarkulluese. Saktësia e vlerës së inventarëve ekonomik pasqyruar në pasqyrat financiare dhe konfirmimi i vlerës së inventarizimit fizik.
3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.
4. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës lidhur me sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për aktivitetin e ndërmarrjes.
5. Analiza dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, kontroll i zbatimit të kontratës dhe marrja në dorëzim të mallrave/shërbimeve në referencë të kërkesave ligjore. Kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe verifikimi i zbatimit të kushteve të kontratës nga komisioni i ngritur për zbatimin dhe marrjen në dorëzim
6. Saktësia e vlerës së pasqyruar në shpenzimet e periudhës kontabël
7. Përcaktimi i vlerës së detyrimeve të papaguara nga blerjet e periudhave të mëparshme.

d. Aktiveve e Trupëzuara dhe të Patrupëzuara (230, 231)

1. Regjistri i aktiveve dhe administrimi i pronës shtetërore
2. Saktësia e vlerës së pasqyruar në aktive sipas klasifikimit bazë kontabël dhe llogaritja e amortizimit të tyre
3. Shtesat e aktiveve gjatë vitit, dhe krahasimi me nevojat për investime të programuara. Argumentimi dhe përlllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për investime.
4. Kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit. Zbatimi i kushteve të kontratës nga komisioni i ngritur për zbatimin dhe marrjen në dorëzim (Paraqitja në formë tabelore të objekteve ndërtimore të përfunduara sipas vlerës, operatori, fitues, data e kontratës, afatet e përfundimit të punimeve sipas kontratës, dhe përzgjedhja e tyre për verifikim në teren, etj.).
5. Pakësimet e aktiveve dhe arsyet e këtyre transaksioneve. Ndjekja e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30 të Ministrisë së Financave
6. Saktësimi i vlerave që prekin bilancin dhe konfirmimi i shifrës me inventarizimin fizik të realizuar në fund të periudhës. Verifikimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhur me administrimin e aktiveve të qëndrueshme.
7. Përcaktimi i vlerës së detyrimeve të papaguara nga investimet e periudhave të mëparshme (lista e detyrimeve e saktësuar përmes testeve të dokumentacionit të disponueshëm)
8. Inventarizimi dhe krijimi i regjistrit/data base të aseteve të për periudhën e auditimit, auditimi i ndryshimeve të aseteve të kryera (dhënie me qira, shitje troje etj.), ligjshmëria dhe rregullariteti i veprimeve të kryera me asetet e qëndrueshme; Auditim mbi statusin juridik të tyre, regjistrimi në ZVRPP.

Në zbatim të pikës V/a.5. të programit të auditimit , sa më sipër, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dosjet e procedurave të prokurimit të fondeve për periudhën 2015-2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

2) Procedurat e prokurimit nga arkiva e sistemit elektronik të APP.

Qëllimi është verifikimi i procedurave të prokurimeve publike të parashikuara dhe realizuara nga APR për periudhën 2015-2017 nëpërmjet evidencave të grumbulluara si dosjet e procedurave të prokurimit, arkiva në sistemin elektronik të prokurimit të APP dhe Urdhër shpenzimeve të likuidimit të faturave për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve nga procedurat e prokurimit publik për periudhën 2015-2017.

Nga auditimi rezultoi që APR ka zhvilluar gjatë vitit 2015 gjithsej 15 procedura prokurimi “Blerje me vlerë të vogël” me fondin limit në total prej 2,404,031 lekë pa tvsh, duke kursyer shumën prej 136,315 lekë, aneksi nr. 1, bashkëlidhur. Sa më sipër janë anuluar 7 procedura, me arsyet përkatëse, aneksi 1/1, bashkëlidhur.

Gjatë vitit 2016, APR ka zhvilluar gjithsej 41 procedura prokurimi “Blerje me vlerë të vogël” me fondin limit në total prej 13,781,695 lekë pa tvsh, duke kursyer shumën prej 2,583,068 lekë, aneksi nr. 2, bashkëlidhur, janë anuluar 16 procedura, me arsyet përkatëse, aneksi 2/2, bashkëlidhur. Ka zhvilluar gjithashtu 30 procedura të llojit kërkesë për propozim, negociim pa shpallje dhe të hapur, me fondin limit në total prej 149,226,480 lekë, duke kursyer shumën prej 4,740,484 lekë, aneksi nr. 4, bashkëlidhur nga të cilat janë anuluar më përpara 12 procedura, me arsyet përkatëse, aneksi 2/2, bashkëlidhur.

Gjatë vitit 2017 (6-mujori I-rë) APR ka zhvilluar gjithsej 8 procedura prokurimi “Blerje me vlerë të vogël” me fondin limit në total prej 2,237,252 lekë pa tvsh, duke kursyer shumën prej 266,802 lekë, aneksi nr. 3, bashkëlidhur, janë anuluar 3 procedura, me arsyet përkatëse, aneksi 3/3, bashkëlidhur. Ka zhvilluar gjithashtu 13 procedura të llojit kërkesë për propozim, negociim pa shpallje dhe të hapur, me fondin limit në total prej 84,545,163 lekë, duke kursyer shumën prej 1,679,5146 lekë, aneksi nr. 5, bashkëlidhur nga të cilat janë anuluar më përpara 3 procedura, me arsyet përkatëse, aneksi 3/3, bashkëlidhur.

Përsa më sipër është mbajtur aktverifikimi nr. 1, datë 17.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1338/16, datë 17.10.2017 për të cilin nuk është paraqitur observacion nga APR.

Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar 3 procedura prokurimi me objekt të njëjtë, si më poshtë:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 353/3, Datë 19.02.2016	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 353/1, dt.19.02.2016	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 353/4 dt. 19/02/2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Me negocijim pa shpallje paraprake të njoftimit”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,995,278.21 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) ■■■ Shpk, 2,974,554.33 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 20,723.88 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

8. Data e hapjes së tenderit 23.02.2016	9. Burimi Financimit Buxheti i APR	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. datë _____	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Shkresa nr..... datë
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 353/16, datë 23.02.2016	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 3,569,465.19 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.

Për procedurën sa më sipër, bashkëlidhur urdhrit të prokurimit nr. 353/3, datë 19.02.2016, ndodhet argumentimi i Njesisë së Prokurimit datë 19.02.2016 mbi arsyet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit “Më negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” (periudha 24.02.2016-30.04.2016). Arsyet kryesore argumentohen miratimi me vonesë i buxhetit nga Këshilli Bashkiak Bashkisë Tiranë dhe koha e pamjaftueshme për zhvillimin e procedurës së rregullt “E hapur” mbështetur dhe në shkresën nr. 353/11, datë 23.02.2016.

Nga auditimi rezulton që buxheti i bashkisë është miratuar në datën 30.12.2016 me VKB nr. 58, i cili është transmetuar dhe mediatikisht dhe është lehtësisht e verifikueshme nëse janë miratuar fondet për këtë lloj shërbimi të cilat rezultojnë të miratuara sipas parashikimit. Në këto kushte, pavarësisht shkresës nr. 342, datë 17.02.2016 të Sektorit të Administrimit Financiar, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse mbi regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, për shkak të nevojave mund të fillohej që në muajin janar procedura e prokurimit e llojit “E hapur” duke shmangur procedurën ndërmjetëse “Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Procedura sa më sipër, përveç konstatimit të përzgjedhjes së saj, dhe mangësive si:

-Në PV e negocimit të çmimit datë 23.02.2016 është cituar” Në këto kushte ftohet operatori ekonomik [REDACTED] për negocimin e çmimit. I kërkohet operatorit ekonomik negocim për çmimin e ofruar në këtë procedurë prokurimi. Operatori ekonomik shprehet se çmimi i ofruar është nën vlerat minimale sipas analizës së çmimit të paraqitur nga ai.”

-Nuk ka CV të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës po një CV të shoqërisë.

-OE i shpallur fitues nuk plotëson kriterin për 40 punonjës të certifikuar pasi ka dy certifikata për të njëjtin person. Në këto kushte kur dy operatorët e tjerë pjesëmarrës janë s’kualifikuar dhe ky operator duhej skualifikuar dhe përsëritej procedura e prokurimit, rezulton në përputhje me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator mbi prokurimet publike.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 648/3, Datë 25.04.2016	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 648/1, dt. 25.04.2016	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Me negociimi pa shpallje paraprake të njoftimit”		Urdhër Nr. 648/4 dt. 25.04.2016
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,717,900 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) [REDACTED], 2,544,637.15 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 173,262.85 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.04.2016	9.Burimi Financimit Buxheti i APR	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 OE b)S’kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr datë_____	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 648/12, datë 29.04.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 3,053,564.58 lekë	16.Likuiduar plotësisht sipas kontratës.

Për procedurën sa më sipër, bashkëlidhur urdhrat të prokurimit nr. 648/3, datë 25.04.2016, ndodhet argumentimi i Njësisë së Prokurimit datë 25.04.2016 mbi arsyet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” (periudha 01.05.2016-30.06.2016). Arsyet kryesore argumentohen me faktin që procedura e nisur “E hapur” për këtë qëllim është anuluar me argumentin se KVO gjatë vlerësimit të procedurës konstaton se më datë 17.03.2016 ishte marrë një Vendim nga ana e KPP i cili arsyeton se “....kosto e armatimit nuk do të përlllogaritet për operatorët ekonomik të cilët provojnë me anë të dokumentacionit konkret se disponojnë armatim në pronësi të tyre,...” dhe duke qenë se nga vlerësimi rezultoi se disa nga ofertuesit kanë llogaritur kosto të armatimit dhe disa jo ka marrë vendim të anuloi procedurën e hapur dhe për këtë shkak të organizohet një procedurë ndërmjetëse deri në organizimin përsëri të procedurës së hapur.

Nga auditimi rezulton se si në procedurën e anuluar ashtu dhe në argumentimin e zgjedhjes së procedurës në këtë prokurim, së pari nuk paraqiten referenca të Vendimit të KPP të marrë si argument dhe së dyti nuk argumentohet si e konstatoi KVO këtë akt në mes të procedurës së vlerësimit.

Anulimi i procedurës së mëparshme dhe organizimi i një procedure ndërmjetëse, pavarësisht se nga ana formale është në përputhje me kërkesat e prokurimit publik, ka sjellë për pasojë eliminimin e konkurrencës nga anulimi i procedurës dhe përzgjedhjen përsëri të të njëjtit operator ekonomik fitues. Në këtë procedurë u konstatua se në kërkesa të veçanta të kualifikimit, kërkohej jo më pak se 30 punonjës të certifikuar kur në të parën kërkohej jo më pak se 40, në të njëjtat kushte operimi lidhur me objektin e kontratës si dhe nga DPQ Tiranë konfirmohet se subjekti i shpallur fitues mbulon 43 objekte me një staf prej 139 punonjës të certifikuar gjë që nuk është konsideruar nga ana KVO duke kërkuar informacione shtesë nëse stafi i licencuar si kapacitet është i angazhuar 100% në gjithë këto objekte dhe nuk jep garanci për zbatimin e kontratës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 399/11, Datë 19.04.2016	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 399/9, dt. 18.04.2016	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 399/12 dt. 19.04.2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,153,699 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) ■■■■, 7,633,908.07 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 519,790.93 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 19.05.2016	9.Burimi Financimit Buxheti i APR	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 12 OE b)S’kualifikuar 11- OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-ka; APP–s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 818 datë 10.06.2016	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Shkresa nr..... datë
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 399/16, datë 30.06.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 9,160,689.68 lekë	16.Likuiduar plotësisht sipas kontratës.

Në këtë procedurë janë adresuar ankesa ndaj Autoritetit Kontraktor si në fazën e shpalljes së kontratës lidhur me kërkesat e veçanta të kualifikimit ashtu dhe në fazën e vlerësimit të ofertave nga disa operator të cilët janë skualifikuar për mangësi të cilat nga autoriteti kontraktor janë vlerësuar, gjykuar dhe është kthyer përgjigje OE ankimues. Një pjesë e ankesave është marrë në konsideratë dhe është reflektuar ndryshimi i kërkuar në kërkesat e veçanta të kualifikimit kurse në ankesat në fazën e vlerësimit, pretendimet e OE të s’kualifikuar nuk janë marrë në konsideratë me argumentet përkatëse, të cilat nga auditimit rezulton se KVO mund ti konsideronte devijime të cilat nuk cenojnë zbatimin e kontratës. Duke qenë ofertat ekonomike kanë qenë në të njëjtin nivel për shkak të vlerës dysheme të pranuar në këtë lloj shërbimi, skualifikimi edhe pse mund të shmangej nuk ndikon në efektivitetin e prokurimit të fondit.

Gjatë vitit 2017, (6-mujori I-rë) janë zhvilluar 2 procedura prokurimi me të njëjtin objekt prokurimi, si më poshtë:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 365/3, Datë 30.01.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 365/1, dt. 30.01.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 365/4 dt. 30.01.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Me negociimi pa shpallje paraprake të njoftimit”		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,693,636.14 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) ■, 4,452,177.36 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 241,458.78 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 03.02.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i APR	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 4 OE b)S’kualifikuar 3- OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP–s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 365/16, datë 06.02.2017	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 5,342,612.839 lekë	16.Likuiduar plotësisht sipas kontratës.

Për procedurën sa më sipër, bashkëlidhur urdhrit të prokurimit nr. 365/3, datë 30.01.2017, ndodhet argumentimi i Njesisë së Prokurimit datë 30.01.2017 mbi arsyet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit “Më negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” (periudha 06.02.2017-06.05.2016). Arsyet kryesore argumentohen miratimi me vonesë i buxhetit nga Këshilli Bashkiak Bashkisë Tiranë dhe koha e pamjaftueshme për zhvillimin e procedurës së rregullt “E hapur”.

Nga auditimi rezulton që buxheti i bashkisë është miratuar në datën 29.12.2017 me VKB nr. 84, i cili është transmetuar dhe mediatikisht dhe është lehtësisht e verifikueshme nëse janë miratuar fondet për këtë lloj shërbimi të cilat rezultojnë të miratuara sipas parashikimit. Në këto kushte, pavarësisht shkresës nr. 3083, datë 24.01.2017 të Bashkisë Tiranë për detajimin e buxhetit, për shkak të nevojave mund të fillohej që në muajin janar procedura e prokurimit e llojit “E hapur” duke shmangur procedurën ndërmjetëse “Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

Pavarësisht përzgjedhjes së procedurës sa më sipër, prokurimi rezulton në përputhje me kërkesat e prokurimit publik.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 601/3, Datë 30.03.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 601/1, dt. 27.03.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 601/4 dt. 30.03.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 17,761,313 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) ■, 16,638,969.82 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,122,343.2 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 24.04.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i APR	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 8 OE



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

		b) S'kualifikuar 7- OE, c) Kualifikuar 1- OE.
11. Ankimime AK-ka; APP-s'ka KPP-ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 639/4, 07.04.2017	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP (Vendim nr. 713/1, datë 12.04.2017)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 601/10, datë 05.05.2017	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 19,966,763.8 lekë	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës.

Në procedurën e organizuar sa më sipër, janë adresuar ankesa të operatorëve ekonomik ndaj autoritetit kontraktor dhe një ankesë ndaj KPP. Nga auditimi rezulton se OE [REDAKTUAR] sh.p.k. që ka dështuar ankesë ndaj KPP është tërhequr nga ankimi sipas Vendimit të KPP nr. 713/1, datë 12.04.2017 kurse ankesat ndaj AK janë vlerësuar dhe është kthyer përgjigje. Mbështetur në raportin përmbledhës nr. 601/8, datë 04.05.2017 dhe sistemin elektronik të APP, rezulton se janë skualifikuar disa OE të cilët rezultojnë me të njëjtën ofertë ekonomike 16,638,969.82 si vlerë dysheme për shkak të natyrës të këtij lloji shërbimi. Arsyet e skualifikimit mund të trajtoheshin si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës por kjo nuk do të ndikonte në efektivitetin e prokurimit të fondeve pasi paraqiten me të njëjtën ofertë ekonomike.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që në të gjitha procedurat është shpallur fitues i njëjti OE, --- [REDAKTUAR] ..

Mbështetur në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit dhe vlerësimin e kërkesave për kualifikim evidentohet fokus i Autoritetit Kontraktor në vlerësim strikt të dokumenteve që plotësojnë kërkesat për kualifikim sidomos ato që mund të trajtohen lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj. të cilat të krijojnë përshtypjen se favorizojnë një operator të caktuar në treg. Ky konkluzion pavarësisht se formalisht mund të ndikojë në konkurrencën e operatorëve në rastin konkret nuk jep impakt në efektivitetin e fondeve publike pasi për shkak të natyrës së shërbimit ofertat ekonomike janë paraqitur në vlera të njëjta me atë të shpallur fituese.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë objekt i veprimtarisë së anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe të KVO sipas të dhënave për çdo procedurë prokurimit të trajtuar në të dhënat e tenderave në këtë aktkonstatim

Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 1, datë 16.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1338/12, datë 16.10.2017 për të cilin janë paraqitur observacionet nga APR, me nr. 1338/12-a, datë 17.10.2017 & 1338/12-b, datë 17.10.2017 nga Njësia e Prokurimit dhe KVO respektivisht për procedurat e trajtuara më sipër. Në observacionin e parë pretendohet se nuk mund të fillojnë procedurat e prokurimit para datës së konfirmimit të ligjshmërisë së VKB mbi miratimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

buxhetit dhe miratimit të detajimit të shpenzimeve operative nga Bashkia Tiranë si Institucion i varësisë. Bashkëlidhur observacionit ndodhen aktet e Bashkisë Tiranë të cilat diktojnë momentin e fillimit të procedurave të prokurimit dhe për këtë shkak observacioni merret në konsideratë dhe ezaurohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Ne observacionin e dytë argumentohet se KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimet publike dhe kjo është evidentuar dhe në trajtimin e procedurave sa më sipër dhe nuk evidentohen mospërputhje, kështu që observacioni merret në konsideratë por qëllimi i trajtimit është që KVO në të ardhmen të mund të jetë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave për kualifikim sidomos ato të veçanta duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar duke u mbështetur në përcaktimet e kuadrit rregullator në fuqi për trajtimin e deviacioneve të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Gjatë vitit 2016 është zhvilluar procedura e prokurimit si më poshtë:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rikualifikimi i fushave sportive pranë varrezave të ushtarëve anglezë në parkun e madh të liqenit të Tiranës”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 1487/2, Datë 31.10.2016	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 1487, dt. 27.10.2016	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 1487/3 dt. 31.10.2016, 1487/5, dt. 25.11.2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 10,533,264 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) ■■■■■, 9,375,275 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,157,989 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 30.11.2016	9.Burimi Financimit Buxheti i APR	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 4 OE b)S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-ka; APP–s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 1514/3, dt. 04.11.2016 & nr. 1547/1, datë 11.11.2016	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Shkresa nr..... datë
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1487/8, datë 13.12.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 11,250,330 lekë	16.Likuiduar plotësisht sipas kontratës.

Në tenderin sa më sipër ka patur dy ankesa ndaj AK në lidhje me kriteret e veçanta të kualifikimit nga të cilat një ankesë nuk është pranuar pasi është adresuar jashtë afatit ligjor. Është vlerësuar ankesa e subjektit “Avduli” shpk, është pranuar dhe janë ndryshuar kriteret e veçanta të kualifikimit sipas kërkesës në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.

Në tender kanë marrë pjesë 4 OE nga të cilët janë skualifikuar 3 OE dhe është kualifikuar OE ■■■■■ shpk me ofertën me vlerë 9,375,275 lekë pa tvsh. Ndër OE të skualifikuar vetëm OE ■■■■■ shpk u paraqit me ofertë ekonomike më të ulët nga oferta e shpallur fituese, me diferencë prej 1,233,289 (9,375,275-8,141,986) lekë. Nga auditimi, mbështetur në Procesverbalin e hapjes së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

ofertave, të vlerësimit të Ofertave dhe në Raportin Përmbledhës nr. 1487/6, datë 12/12/2016 rezultojnë se OE “Avduli” shpik është skualifikuar pasi nuk plotëson dy kritere të veçanta të kualifikimit të cilat mund të konsideroheshin nga KVO si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës (mungesa e urdhërpagesës së Sig. Shoqërore vetëm për një muaj dhe një licencë e QKL (kodi III.2.B) dhe me peshën kryesore në vendimmarrjen e KVO është ekzistenca në historikun e subjektit e Urdhrit nr. 322, datë 23.06.2016 të shoqërisë përmbartimore private për vendosje të sekuestros konservative mbi kuotat/aksionet e shoqërisë si dhe të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave deri në një urdhër të dytë. Duke qenë se nuk ekziston një urdhër i dytë për heqjen e sekuestros edhe në datën e hapjes së ofertave KVO e ka konsideruar mungesë besueshmërie dhe reputacioni në bazë të të cilës nuk mund të besohet kësaj shoqërie kontrata sa më sipër dhe është skualifikuar.

Duke parë dobishmërinë e kësaj oferte, KVO mund të kërkonte informacione shtesë mbi këtë çështje nga subjekti dhe të shikonte mundësinë e besueshmërisë dhe reputacionit të subjektit pasi ekstrakti historik mbi të cilën është bazuar KVO në këtë vendim, në DST është përcaktuar se shërben për të vërtetuar se subjekti nuk është në proces falimentimi, nuk është dënuar për shkelje penale dhe me vendim të formës së prerë që lidhet me aktivitetin profesional të cilat subjekti i plotëson 100%.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që procedura përputhet formalisht me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimin publik por që nuk është vlerësuar sigurimi i efektivitetit të fondeve në këtë procedurë sipas konstatimit të trajtuar më sipër.

Mbështetur në vlerësimin e kërkesave për kualifikim evidentohet fokus i Autoritetit Kontraktor në vlerësim strikt të dokumenteve që plotësojnë kërkesat për kualifikim sidomos ato që mund të trajtohen lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj. “të cilat do të krijojnë mundësinë e shpalljes fituese të OE [REDAKTUAR] me ofertë më të ulët duke siguruar kursimin e fondeve prej 1,233,289 (9,375,275-8,141,986) lekë diferenca nga oferta e shpallur fituese.

Veprimet dhe mosveprimet sa trajtuar më sipër janë objekt i veprimtarisë së anëtarëve të KVO sipas të dhënave të tenderit në tabelën më sipër.

Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 2, datë 16.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1338/13, datë 16.10.2017 për të cilin është paraqitur observacion nga APR, me nr. 1338/13-a, datë 18.10.2017 nga KVO respektivisht për procedurën e trajtuar më sipër. Ne observacion argumentohet se KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimet publike dhe kjo është evidentuar dhe në trajtimin e procedurave sa më sipër dhe nuk evidentohen mospërputhje, kështu që observacioni merret në konsideratë por qëllimi i trajtimit është që KVO në të ardhmen të mund të jetë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave për kualifikim sidomos ato të veçanta dhe të mos hezitojë të kërkojë informacione shtesë dhe shpjegime nga OE duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar duke u mbështetur në përcaktimet e kuadrit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

rregullator në fuqi për trajtimin e deviacioneve të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Gjatë vitit 2016 është zhvilluar procedura e prokurimit si më poshtë:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje drurë e shkurre”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 618/3, dt. 16.08.2016	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 618/1, dt. 19.04.2016	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 618/4, dt. 16.08.2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 16,666,557 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) ■■■ shpk, 16,566,357 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 100,200 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 09.09.2016	9.Burimi Financimit Buxheti i APR	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 7 OE b)S’kualifikuar 6- OE, c) Kualifikuar 1- OE.
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 618/8, datë 06.10.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 19,879,628 lekë	16.Likuiduar plotësisht sipas kontratës.

Në tenderin sa më sipër kanë marrë pjesë 7 OE nga të cilët janë skualifikuar 6 OE dhe është kualifikuar OE ■■■ shpk me ofertën me vlerë 16,566,357 lekë pa tvsh. Ndër OE të skualifikuar OE ■■■ shpk u paraqit me ofertë ekonomike më të ulët nga oferta e shpallur fituese, me diferencë prej 2,394,157 (16,566,357-14,172,200) lekë. Nga auditimi, mbështetur në Procesverbalin e hapjes së ofertave, të vlerësimit të Ofertave dhe në Raportin Përmbledhës nr. 618/6, datë 03/10/2016 rezulton se OE ■■■ shpk është skualifikuar pasi nuk plotëson kriteret të veçanta të kualifikimit të cilat mund të konsideroheshin nga KVO si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës (-Bilanci 2014, pasqyrat financiare, janë të pakonfirmuara dhe vulosura faqe më faqe nga organet tatimore; -Data e dorëzimit tek deklaratat e gjendjes gjyqësore, specifikimet teknike dhe konflikti i interesit është data 06/09/2016 dhe jo data e hapjes së ofertave; -Për kamionin mungon polica e sigurimit dhe për tre specialistë ka paguar më shumë se sa ka deklaruar paga dhe sigurime shoqërore).

Duke parë dobishmërinë e kësaj oferte, KVO mund të kërkonte informacione shtesë mbi devijimet sa më sipër dhe të vlerësonte mundësinë e kualifikimit të OE ■■■ shpk.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që procedura përputhet formalisht me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimin publik por që nuk është vlerësuar siguri i efektivitetit të fondeve në këtë procedurë sipas konstatimit të trajtuar më sipër.

Mbështetur në vlerësimin e kërkesave për kualifikim evidentohet fokus i Autoritetit Kontraktor në vlerësim strikt të dokumenteve që plotësojnë kërkesat për kualifikim sidomos ato që mund të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

trajtohen lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.” të cilat do të krijojnë mundësinë e shpalljes fitues të OE “Albgarden” sh.p.k. me ofertë më të ulët duke siguruar kursimin e fondeve prej 2,394,157 (16,566,357-14,172,200) lekë diferenca nga oferta e shpallur fituese.

Veprimet dhe mosveprimet sa trajtuar më sipër janë objekt i veprimtarisë së anëtarëve të KVO sipas të dhënave të tenderit sa më sipër.

Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 3, datë 17.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1338/14, datë 17.10.2017 për të cilin është paraqitur observacion nga APR, me nr. 1338/14-a, datë 20.10.2017 nga KVO respektivisht për procedurën e trajtuar më sipër. Ne observacion argumentohet se KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimet publike dhe kjo është evidentuar dhe në trajtimin e procedurave sa më sipër dhe nuk evidentohen mospërputhje, kështu që observacioni merret në konsideratë por qëllimi i trajtimit është që KVO në të ardhmen të mund të jetë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave për kualifikim sidomos ato të veçanta dhe të mos hezitojë të kërkojë informacione shtesë dhe shpjegime nga OE duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar duke u mbështetur në përcaktimet e kuadrit rregullator në fuqi për trajtimin e deviacioneve të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Gjatë vitit 2016 është zhvilluar procedura e prokurimit si më poshtë:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 1397/3, dt. 14.10.2016	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 1397/1, dt. 07.10.2016	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 1397/4, dt. 14.10.2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,499,982 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) [REDACTED] shpk, 2,472,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 27,982 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.10.2016	9.Burimi Financimit Buxheti i APR	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE b)S’kualifikuar 2- OE, c) Kualifikuar 1- OE.
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr.	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1397/8, datë	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 2,966,400 lekë	16.Likuiduar plotësisht sipas kontratës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

01.12.2016		
------------	--	--

Në tenderin sa më sipër kanë marrë pjesë 3 OE nga të cilët janë skualifikuar 2 OE dhe është kualifikuar OE [REDACTED] shpk, me ofertën me vlerë 2,472,000 lekë pa tvsh. Ndër OE të skualifikuar OE [REDACTED] shpk u paraqit me ofertë ekonomike më të ulët nga oferta e shpallur fituese, me diferencë prej 300,110 (2,472,000 - 2,171,890) lekë. Nga auditimi, mbështetur në Procesverbalin e hapjes së ofertave, të vlerësimit të Ofertave dhe në Raportin Përmbledhës nr. 1397/6, datë 08/11/2016 rezulton se OE [REDACTED] shpk është skualifikuar pasi nuk plotëson kritere të veçanta të kualifikimit të cilat mund të konsideroheshin nga KVO si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës (-Nuk ka paraqitur vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për muajin shtator; -Nuk ka paraqitur katalog ose fragmente katalogu për profile, plastmasë, polikarbonat; -Çertifikata ISO 9001:2008 nuk është e akredituar nga Institucionet përkatëse siç kërkohet në DST).

Duke parë dobishmërinë e kësaj oferte, KVO mund të kërkonte informacione shtesë mbi devijimet sa më sipër dhe të vlerësonte mundësinë e kualifikimit të OE [REDACTED] shpk.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që procedura përputhet formalisht me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimin publik por që nuk është vlerësuar sigurimi i efektivitetit të fondeve në këtë procedurë sipas konstatimit të trajtuar më sipër.

Mbështetur në vlerësimin e kërkesave për kualifikim evidentohet fokus i Autoritetit Kontraktor në vlerësim strikt të dokumenteve që plotësojnë kërkesat për kualifikim sidomos ato që mund të trajtohen lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.” të cilat do të krijojnë mundësinë e shpalljes fitues të OE “Bolt” sh.p.k. me ofertë më të ulët duke siguruar kursimin e fondeve prej 300,110 (2,472,000 - 2,171,890) lekë, diferenca nga oferta e shpallur fituese.

Veprimet dhe mosveprimet, sa trajtuar më sipër, janë objekt i veprimtarisë së anëtarëve të KVO sipas të dhënave të tenderit në tabelën më sipër në këtë raport auditimi.

Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 4, datë 17.10.2017, protokolluar në APR me nr. 1338/15, datë 17.10.2017 për të cilin është paraqitur observacion nga APR, me nr. 1338/15-a, datë 20.10.2017 nga KVO respektivisht për procedurën e trajtuara më sipër. Ne observacion argumentohet se KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimet publike dhe kjo është evidentuar dhe në trajtimin e procedurave sa më sipër dhe nuk evidentohen mospërputhje, kështu që observacioni merret në konsideratë por qëllimi i trajtimit është që KVO në të ardhmen të mund të jetë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave për kualifikim sidomos ato të veçanta dhe të mos hezitojë të kërkojë informacione shtesë dhe shpjegime nga OE duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar duke u mbështetur në përcaktimet e kuadrit rregullator në fuqi për trajtimin e deviacioneve të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.-Gjetje nga auditimi: APR ka filluar aktivitetin në tetor 2015, kur zyrtarisht është përcjellë nga Bashkia Tiranë, me shkresë nr. 1692, datë 01.10.2015, Vendimi i KB për krijimin e APR. Në prill të vitit 2016, është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, me nr. 10286/1, datë 22.04.2016 Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të APR. Si rezultat i ndryshimeve në shtim të kompetencave dhe përgjegjësi si dhe të stafit, është përmirësuar rregullore e brendshme dy herë dhe miratuar me nr. 22107/1, datë 05.08.2016 dhe me nr. 24478/3, datë 29.06.2017. Rregullorja është mbështetur në kuadrin rregullator në fuqi kryesisht legjislativ për njësitë e vetëqeverisjes vendore, legjislativ për marrëdhëniet e punës dhe funksionimin administrativ dhe VKB. Evidentohet se në bazën ligjore nuk është parashikuar ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. APR nuk ka funksionuar në bazë strategjish periodike dhe objektivat prioritar reflektohen në progres raportin e vitit 2016. Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezultoi se për periudhën objekt i auditimit në APR nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të përshkuara në rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative. APR nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara agjencisë. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim rezultoi se në APR nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. (Sa më sipër trajtuar në detaje në faqet nr. 12-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1- Rekomandimi:- Drejtori i Përgjithshëm i APR, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së APR, identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të APR duke marrë në konsideratë dhe prioritetet e Bashkisë Tiranë për funksionet në të ardhmen të APR.

b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

1.2- Rekomandimi:-Drejtori i Përgjithshëm i APR të caktojë një koordinator risku me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në APR për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshëm dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të APR.

Rekomandimet sa më sipër, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

2.-Gjetje nga auditimi:- Për vitin 2016 APR ka analizuar situatën dhe ka parashikuar nevojat për buxhetin e vitit 2016 në bazë drejtorish por që nuk është dokumentuar pasi si orientim kanë shërbyer udhëzimet e Bashkisë Tiranë për llogaritjen e nevojave sipas programeve bazë të buxhetit të institucionit të varësisë. Në këto kushte, APR pavarësisht se llogaritja e buxhetit për plotësimin e kërkesave në realizimin e funksioneve të ngarkuara për të ushtruar ka qenë në shifra më të larta pas negociimeve me strukturat e Bashkisë Tiranë në stadin final ka propozuar shifrat e rëna dakord të cilat janë miratuar plotësisht. Duke qenë se buxheti i miratuar nuk ka qenë në përputhje me nevojat reale të APR për vitin 2016, mbështetur dhe në shtimin e funksioneve gjatë vitit, janë realizuar shtesa fondesh gjatë vitit dhe rialokime të cilat janë miratuar në Këshillin Bashkiak respektivisht sipas propozimeve të rëna dakord midis APR dhe Bashkisë Tiranë. Në këto kushte në buxhetin final vjetor janë shtuar fonde në shumën 9,450,000 lekë nga Bashkia Tiranë në artikullin 600, 601 dhe 602 dhe totali i buxhetit paraqitet në shumën 374,450,000 lekë. Gjithashtu janë pakësuar gjatë vitit shpenzimet operative në shumën 10,515,360 lekë të cilat janë rialokuar në artikullin 231, investime. Shtesa e fondeve dhe rialokimi janë miratuar në strukturat kompetente të Bashkisë Tiranë sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi. Për vitin 2017, APR është përfshirë në procesin e përgatitjes së PBA 2017-2019, për Bashkinë Tiranë dhe buxhetin korent për vitin 2017. Mbështetur në shkresën nr. 24220, datë 05.08.2016 të Bashkisë Tiranë mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019, Drejtori i Përgjithshëm i APR, ka urdhëruar me shkresë nr. 1147/1, datë 12.08.2016 ngritjen e Komisionit “Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019” të përbërë nga drejtuesit kryesor të drejtorive dhe njësi të APR të cilët kanë organizuar punën për përgatitjen e PBA sipas procedurave standarde të Udhëzimit të MF nr. 4, datë 29.02.2016. Në përfundim të procesit është propozuar programi buxhetor i APR në Bashkinë Tiranë me shkresë nr. 1147/2, datë 06.09.2016 sipas afateve të përcaktuara. Formalisht PBA e parashikuar dhe propozuar i qëndron programeve të institucionit të varësisë dhe argumentet parashikohen në relacionin mbi objektivat dhe prioritetet e APR afatmesme dhe ato vjetore. Në rubrikat e pasqyrave mbi parashikimet buxhetore evidentohet se në mënyrë skematike është respektuar programi buxhetor i Institucionit të Varësisë por nuk janë përshkallëzuar në nivel APR në kuptimin e parashikimit dhe llogaritjes së nevojave sipas objektivave të programit me aktivitete të cilat bëjnë të mundur realizimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

objektivave të programit. (Sa më sipër trajtuar në detaje në faqet nr. 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Rekomandimi:- Njësia e Planifikimit dhe Administrimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të marrin masa për të organizuar procesin e përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm dhe atë të vitit korrent sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet vjetore të Ministrisë Financave për përgatitjen e projektbuxhetit duke identifikuar nevojat reale për fonde dhe propozuar ato sipas gjendjes reale dhe jo sipas fondeve të rëna dakord me strukturat përkatëse në Bashkinë Tiranë, pavarësisht nivelit të miratimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë. Fondet sipas programeve të lidhen me politikat dhe objektivat e programit dhe të shtrihen në nivel aktiviteti për të argumentuar domosdoshmërinë e fondeve të kërkuara duke përmirësuar punën e nisur në projektbuxhetin e vitit 2017 dhe përafruar me standardet dhe procedurat e përgatitjes së projektbuxhetit sipas përcaktimeve në aktet normative relevante në fuqi, kryesisht Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet periodike të MF për përgatitjen e PBA dhe projektbuxhetit të vitit korrent.

C.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

-Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2016, në tre procedura prokurimi është evidentuar mos siguri i dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike pasi Autoriteti Kontraktor ka skualifikuar operator ekonomik për aspekte që formalisht përputhen me përcaktimet ligjore por që mund të trajtoheshin lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.” të cilat do të krijonin mundësinë e shpalljes fituese të OE të skualifikuar me ofertë më të ulët duke siguruar kursimin e fondeve në shumën prej 3,927,556 lekë, respektivisht 1,233,289 (9,375,275-8,141,986) lekë diferenca nga oferta e shpallur fituese në procedurën me objekt : “Rikualifikimi i fushave sportive pranë varrezave të ushtarëve anglezë në parkun e madh të liqenit të Tiranës”; 2,394,157 (16,566,357-14,172,200) lekë diferenca nga oferta e shpallur fituese në procedurën me objekt : “Blerje drurë e shkurre” dhe, 300,110 (2,472,000 -2,171,890) lekë diferenca nga oferta e shpallur fituese në procedurën me objekt : “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike” (Më hollësisht trajtuar në faqet 27-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

- Rekomandimi:- Autoriteti Kontraktor, APR, të marrë masa që KVO në të ardhmen të mund të jenë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave për kualifikim, sidomos ato të veçanta, dhe të mos hezitojë të kërkojë informacione shtesë dhe shpjegime nga OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të APR duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar duke u mbështetur në përcaktimet e kuadrit rregullator në fuqi për trajtimin e deviacioneve të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës me qëllim menaxhimin sa më ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve publike.

V. OPINIONI AUDITIMIT

Në bazë të punës audituese të kryer, të përshkruar në Kreun II të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Grupit të Auditimit i rezulton se veprimtaria e APR, për periudhën 2015-2017, është në përputhje në çdo aspekt material me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, Kreu I, germa g) të Raportit Përfundimtar të Auditimit për sa i përket: (i) Mbylljes së llogarive vjetore në 31 dhjetor 2016, respektimit të afatit të nxjerrjes së bilancit kontabël, plotësimit të pasqyrave financiare, (ii) Ndarjes së aktivitetit të ish-Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1, të Punëtorëve të Qytetit Tiranë me APR si përsa i përket transferimit të të drejtave dhe detyrimeve ashtu dhe për personelin dhe aktivet, (iii) Saktësisë së paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare, (iiii) Pasqyrimit të të ardhurave në tërësi dhe ato dytësore në veçanti në kontabilitet, (iiiii) Menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrimit të marrëdhënieve të punës, (iiiii) Llogaritjes, likuidimit dhe administrimit financiar të pagave, shpërblimeve dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, (iiiii) Administrimit, ruajtjes, dokumentimit dhe qarkullimit të vlerave materiale dhe monetare, veprimeve nëpërmjet bankës, (iiiii) Zbatimit të kontratave, kontrollit fizik dhe marrjes në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve, pasqyrimit në shpenzimet e periudhës kontabël, (iiiii) Regjistrimit të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, kontabilizimit të tyre, inventarizimit dhe amortizimit respektiv.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur janë materiale por që nuk ndikojnë në opinionin e auditimit, të cilat kryesisht konsistojnë si më poshtë:

Përsa i përket: (i) Funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, funksionimi i APR jo në bazë të strategjive periodike të mirë përcaktuara, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, (ii) Procesit të programimit të buxhetit të njësisë, propozimii i nevojave jo sipas analizës dhe gjendjes reale të APR por sipas konkluzioneve të negociatave me Bashkinë Tiranë, jo sipas përcaktimeve në ligjet dhe udhëzimet periodike të përgatitjes së projektbuxheteve, (iii) Prokurimit të fondeve për mallra dhe shërbime, në 5 procedura ku Autoriteti Kontraktor duhej të mbështetej më shumë tek qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve dhe jo



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Tiranë

strikt i vlerësimit të kërkesave për kualifikim të Operatorëve Ekonomik, tre çështjet e fundit trajtuar në Kreun. IV, Gjetje dhe Rekomandime të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT